



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23 regjistër (JR)
Datë 10.05.2021

Nr. 30 i vendimit
Datë 14.07.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi dhe atë publike, në datat 20.06.2023, 12.07.2023 dhe 14.07.2023, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Aleks Nikolli, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 290, datë 10.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Aneksi i Kushtetutës, nenet A-G të Kushtetutës, nenet 5/2 dhe 63 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, jurisprudenca e GjEDNj-së dhe e Gjykatës Kushtetuese, opinionet e Komisionit të Venecias për Shqipërinë, etj.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi e më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e paraqitura në ankim dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në parashtrime e tij në seancë gjyqësore, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë në tërësi,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Aleks Nikolli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Shkodër, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), pasi administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), kreu hetimin e plotë administrativ vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
3. Në përfundim, me vendimin nr. 290, datë 10.08.2020, Komisioni vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Aleks Nikolli, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër*”. Ky vendim mbështetet në vlerësimin tërësor të procedurave për kriterin e pasurisë. Vendimi i Komisionit u bazua në pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 dhe shkronjën “c”, pika 1, të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet e arritura se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë të pasurisë; (ii) ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë; (iii) ka kryer veprime jo në përputhje me ligjin me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore; (iv) ka kryer veprime juridike fiktive me qëllim final ligjërimitin e të ardhurave financiare nga burime të pidentifikuara; (v) ka kryer veprime juridike jo të besueshme/fiktive me qëllim justifikimin e fshehjes së pasurisë në emër të personave të tjerë të lidhur; (vi) rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare, ndër vite, në shumën 4.599.216 lekë; (vii) personat e tjerë të lidhur me subjektin rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme financiare për ndërtimin e banesës trekatëshe në vitet 2003-2004, si dhe për blerjen e apartamentit dhe ndërtimin e shtesave në Lezhë në vitet 2010-2014.

Në vlerësim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, bazuar në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut bazuar në pikën 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Aleks Nikolli

4. Kundër vendimit nr. 290, datë 10.08.2020, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Aleks Nikolli, nëpërmjet të cilit i kërkon Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) çeljen e hetimit gjyqësor për kriterin e figurës dhe të vlerësimit profesional e në përfundim të gjykimit konfirmimin e tij në detyrë ose prishjen e vendimit nr. 290, datë 10.08.2020, të Komisionit dhe ridërgimin e çështjes për rigjykim.

Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe me natyrë procedurale që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe shkaqe mbi themelin e çështjes për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

5. **Shkaqet me natyrë procedurale që lidhen me procesin e rregullt ligjor konsistojnë në mënyrë të përmbledhur si vijon.**

5.1. Komisioni ka shfaqur haptazi anshmërinë gjatë hetimit administrativ, duke pasur për qëllim sajimin dhe hiperbolizimin e problemeve në raportin përfundimtar dhe mbylljen e hetimit administrativ për një kriter, duke iu nënshtuar paracaktimit të vendimit që do të merrej ndaj tij. Vendimi i Komisionit është i padrejtë dhe i pambështetur në prova, fakte dhe ligj, rezultat i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të provuara gjatë procesit administrativ.

5.2. Komisioni ka mbajtur qëndrim diskriminues ndaj subjektit të rivlerësimit dhe në vendim nuk janë trajtuar praktika të ndryshme të Komisionit në raste të mëparshme, referuar prej tij. Interpretimet doktrimore dhe parimore të ligjit dhe të çmimit të fakteve nga ana e Komisionit, në rastet kur vendimet e tij për konfirmimin në detyrë nuk janë ankimuar nga palët, kanë forcën ndikuese dhe detyruese të precedentit për t’u ndjekur, të detyrueshme për zbatim në vijim nga organet e rivlerësimit, njëjloj sikundër vendimet e Kolegjit.

5.3. Sipas subjektit, i është mohuar e drejta për t’u dëgjuar gjatë hetimit administrativ, duke mos i vënë në dispozicion kohën e nevojshme për të realizuar mbrojtjen efektive, si dhe gjatë seancës dëgjimore nuk i është lejuar të parashtrijë në detaje kundërshtimet ndaj gjetjeve të relatuar.

5.4. Mungon vendimmarrja formale e Komisionit për çdo kërkesë për riçelje të hetimit për të tria kriteret e rivlerësimit. Komisioni nuk kishte kohë të mjaftueshme mes datës së seancës dëgjimore dhe shpalljes së vendimit, për leximin, marrjen në analizë, si dhe marrjen në konsideratë të prapësimeve të tij.

5.5. Subjektit të rivlerësimit i është mohuar e drejta e mbrojtjes efektive, pasi i janë rrëzuar në mënyrë të pambështetur në ligj kërkesat e përsëritura për vënien në dispozicion të gjithë akteve të ndodhura në dosje, përfshirë ato që i përkasin kriterit të figurës dhe vlerësimit profesional, për shkak të mungesës së njohjes me arsyet e qarta për mbylljen e hetimit dhe të gjithë procesit të rivlerësimit me një kriter, si dhe rrëzimit të pabazuar të kërkesës për njohjen me komunikimin dhe përcjelljen tek ONM-ja të shpjegimeve, kërkesave dhe prapësimeve të tij përfshirë ato të seancës dëgjimore, si dhe njohjen me mendimet apo opinionet e tyre.

5.6. Komisioni ka dhënë një vendim të paarsyetuar, të cilit i mungon tërësisht ana përmbajtësore, për shkak të mosdhënies përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mosanalizimit të vlerës dhe fuqisë provuese të provave të marra. Vendimi i Komisionit është i

mbushur me alogjizma, kontradikta të ndryshme dhe shmangie të provave, për më tepër, për një çështje relatori ka paraqitur si pjesë të vendimit mendimin e tij personal.

5.7. Gjithashtu, ka vendosur në kundërshtim me nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kriterëve, megjithëse vendimi përfundimtar merret bazuar në një ose disa prej kriterëve.

5.8. Komisioni nuk ka mbajtur parasysh parimin e pafajësisë dhe është fokusuar në kundërshtimin e mundësive të një kohe ekonomike të largët, për të cilën nuk ka asnjë mundësi objektive për gjetje dokumentacioni shkresor, duke cenuar kështu parimin e sigurisë juridike. Konsiderimi i provave si të pamjaftueshme për vitet 1990-2010, kur shumë institucione vendase apo të huaja nuk ruajnë dokumentacion, është i paarsyeshëm, i padrejtë dhe i pabazuar në ligj.

5.9. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, në respektim të së cilëve, për procesin e rivlerësimit, ligjvënësi ka vendosur standardin e moslejimit të justifikimit më shumë se dyfishi i pasurisë me të ardhura të ligjshme të dokumentuara.

5.10. Komisioni ka zbatuar gabim nenin 52, paragrafi i dytë të ligjit nr. 84/2016, pasi i ka ngarkuar në mënyrë të padrejtë barrën e provës subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që ishte Komisioni që duhej të provonte pamundësinë financiare të pretenduar.

5.11. Nisur nga informacionet në media rreth dyshimeve mbi procedurën e emërimit dhe plotësimit të kriterëve ligjore të disa anëtarëve të Komisionit, Kolegji duhet të marrë në shqyrtim dhe në analizë respektimin e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sa i përket *gjykatës së krijuar me ligj*, të analizojë, qoftë edhe kryesisht, respektimin e standardeve të vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, që kanë kryer procesin e tij të rivlerësimit.

6. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë në mënyrë të përmbledhur si vijon.

6.1 Përfundimet e Komisionit, për mungesë të burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve, krijimin e pasurive dhe ndërtimin e banesës 3-katëshe në {***}, Lezhë, në shumën 4.133.466 lekë, në vitin 2003, për subjektin e rivlerësimit dhe në shumën 4.622.624 lekë në vitet 2003-2004, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, si dhe përfundimet për kryerjen e veprimeve jo në përputhje me ligjin, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore në caktimin e një çmimi joreal në kontratën e shitjes në vitin 2004 ndërmjet tij dhe vëllait K. N., janë rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit, në kundërshtim me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 84/2016.

6.2 Konkluzioni i Komisionit se shuma prej 1.250.000 lekësh, kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK, përbën ligjërim të disa burimeve financiare të pidentifikuara të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet veprimeve fiktive me shoqërinë ndërtuese është i pabazuar në ligj e në fakte dhe rrjedhojë e trajtimit të gabuar të aktmarrëveshjes së datës 08.05.2018, lidhur mes tij dhe shoqërisë, nga e cila ai nuk ka përfituar efektivisht shtim të pasurive, por ka dalë i dëmtuar në

vlerë reale pasurore, dhe shtrirja e kontrollit për këtë veprim juridik të vitit 2018 është tej afatit të periudhës së rivlerësimit.

6.3 Konkluzioni i Komisionit se ka bërë deklaram të pasaktë të gjendjes *cash* në shumën 100.000 lekë, pasi nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2015, nuk duhet të ndikojë në procesin e rivlerësimit, për shkak të vlerës së vogël, pa ndikim apo përdorim në krijimin e pasurive, si dhe faktin se kjo pakujdesi është mbartur nga deklaramet periodike vjetore pararendëse.

6.4 Lidhur me huapërdorjen e ndërsjellët (reciproke pa shpërblim), mes subjektit dhe të vëllait L. N., për apartamentin me sipërfaqe 147,8 m² dhe pjesën e pandarë të tokës bujqësore përreth me sipërfaqe 700 m², në {***}, Lezhë, në pronësi të subjektit dhe të apartamentit në pronësi të vëllait L. N. në qytetin e Lezhës, i përbërë nga tri pasuri (për shkak të mënyrës së ndryshme të fitimit të pronësisë dhe kohës së regjistrimit të tyre në ZVRPP), trajtimi i kësaj marrëdhënie si përfitimi dhe konsiderimi i vëllait si person tjetër i lidhur është krejtësisht i gabuar dhe i pabazuar në ligj. Përfundimet individuale të relatorit të shprehura abuzivisht në vendim si përfundime të shumicës, për pronësinë reale të apartamentit në huapërdorje prej tij, janë paragjyquese dhe tërësisht të pabazuara në provat e dorëzuara prej tij, të cilat provojnë qartë pronësinë e kësaj pasurie dhe origjinën e ligjshme të krijimit të saj.

6.5 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se, në tërësi të rrethanave dhe fakteve të shitjes së njësisë me sipërfaqe 12 m² të ndodhur në qytetin e Lezhës, sjelljet e tij dëshmojnë ndërmarrjen e veprimeve juridike fiktive, me qëllimin final ligjërimin e të ardhurave financiare nga burime të paidentifikuara, qoftë në formën e veprimeve të tij dhe personave të lidhur në kundërshtim me ligjin. Sipas subjektit, çmimi i shitjes nuk ka qenë më i lartë se çmimet e tregut dhe nuk janë marrë në konsideratë shpjegimet e hollësishme të dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, të cilat krijojnë bindje të plotë se nuk ka pasur asnjë arsye për caktim të një çmimi fiktiv.

6.6 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka asnjë detyrim ligjor për të vërtetuar burimin e ligjshëm të shumave 20.000 euro dhe 40.000 euro të depozituara në datën 31.07.2009 në bankë, në emër të nënës së tij D. N., me të ardhurat e vëllait L. N. dhe bashkëshortes së tij, nga puna si emigrantë në Angli, pasi nëna e tij nuk është person i lidhur dhe as person tjetër i lidhur, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Megjithatë, nga analiza e detajuar ka provuar burimin e ligjshëm të tyre, mundësinë financiare të vëllait L. N. dhe bashkëshortes së tij për krijimin e shumës 55.000 euro dhe të nënës së tij për krijimin e diferencës 5.000 euro.

6.7 Lidhur me analizën financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se: (i) pamundësia për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në vitin 2003 nuk ka të bëjë me vlerësimin e pasurive të tij gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarit; (ii) për vitet 2012, 2013 dhe 2014, informacioni i ILDKPKI-së është zbatuar në mënyrë të gabuar e, për rrjedhojë, shpenzimet e jetesës së familjes së tij janë përlllogaritur gabim; (iii) nga pikëpamja metodologjike nuk janë mbajtur në konsideratë prodhimet e tij bujqësore apo dhënë nga të tjerë si ekuivalent i vlerave monetare, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, logjikën ekonomike dhe mënyrën e tij reale të jetesës.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Aleks Nikolli, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vlerëson se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit nr. 290, datë 10.08.2020, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin nga subjekti i rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues”) fillimisht në dhomë këshillimi në datën 20.06.2023.
10. Trupi gjykues, gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi shqyrtoi shkaqet procedurale të ankimit, lidhur me pasurinë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, apartament banimi me dy shtesa anësore (deklaruar si huapërdorje e ndërsjellë, reciproke dhe pa shpërblim) ndodhur në lagjen “{***}”, rruga “{***}”, në qytetin e Lezhës, vlerësoi se konkluzioni i Komisionit është bazuar në shkelje procedurale, të cilat trajtohen hollësisht në vijim të këtij vendimi dhe vendosi, me vendim të ndërmjetëm, të kalojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për t’i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012. Për çështjet e tjera objekt ankimi, trupi gjykues nuk konstatoi ekzistencën e asnjë prej kushteve të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2019, për rrjedhojë gjykimi për to vijoi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi. Seanca dëgjimore në Kolegji, lidhur me pasurinë e sipërcituar, u zhvillua më datë 12.07.2023.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi shkaqet procedurale të ankimit

11. Kolegji, në kushtet kur kaloi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke i dhënë përgjigje shkakut ankimor me natyrë procedurale të referuar në paragrafin më lart, në vijim analizoi shkaqet e tjera ankimore të kësaj natyre, duke konkluduar si vijon.

11.1. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka ruajtur paanësinë dhe pavarësinë, duke iu nënshtruar kështu paracaktimit të vendimit që do të merrej ndaj tij, shkak për këtë, sipas subjektit, është bërë një fushatë denigrimi dhe përbaltje nga eksponentët më të lartë të pushtetit ekzekutiv me thirrje të hapura publike për ndëshkim ndaj tij. Subjekti i rivlerësimit nuk referon të dhëna konkrete lidhur me këtë pretendim, por nga burime të hapura konstatohet se deklaratimet e aktorëve vendas dhe partnerë ndërkombëtarë në media lidhen me kontrollin e ligjshmërisë së një vendimmarrjeje të një trupe gjyqësore në të cilën subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë, për një çështje me impakt mediatik. Ministrja e Drejtësisë, për këtë rast, ka informuar publikisht se pas verifikimit paraprak i është drejtuar me kërkesë KLGj-së, për fillimin e hetimit disiplinor dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe dy gjyqtarëve të tjerë të asaj trupe gjyqësore, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës. KLGj-ja, gjithashtu, ka informuar publikisht se do të trajtonte me paanshmëri dhe profesionalizëm kërkesën dhe në përputhje me kuadrin ligjor do të ndërmernte çdo veprim në respektim të ligjit. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se procesi i rivlerësimit dhe vendimmarrja e institucioneve të rivlerësimit bazohet vetëm mbi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore, në rastin konkret në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe vjen si rezultat i një procesi të pandikuar nga deklaratata publike. Për më tepër, vlen të theksohet që çështja e sjellë në vëmendje lidhet me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, kriter i pavlerësuar e, për pasojë, pa peshë, dhe jo shkak për shkarkimin e tij nga detyra. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.

11.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, Komisioni ka shfaqur haptazi anshmërinë gjatë hetimit administrativ, duke pasur për qëllim sajimin dhe hiperbolizimin e problemeve dhe mbylljen e hetimit administrativ për një kriter e, për rrjedhojë, vendimi i Komisionit është i padrejtë dhe i pambështetur në prova, fakte dhe ligj, rezultat i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të provuara gjatë procesit administrativ, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën¹ e tij sjell në vëmendje si vijon.

11.2.1. Ligji nr. 84/2016, në nenin 52, pika 2 të tij, parashikon se Komisioni, nëse arrin në përfundimin se provat e administruara kryesisht dhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kanë nivelin e provueshmërisë, i kalon atij barrën e provës, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Barra e provës i përcillet subjektit nëpërmjet raportit “Rezultatet e hetimit administrativ”, në të cilin parashtrihen çështjet, përmenden provat dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe kërkohen shpjegime. Nga analizimi i raportit të Komisionit për rezultatet e hetimit, si dhe i vendimit objekt shqyrtimi,

¹ Shih vendimet e Kolegjit nr. 1/2019 (JR), nr. 2/2019 (JR), nr. 5/2019 (JR), nr. 1/2020 (JR), nr. 2/2020 (JR), nr. 3/2020 (JR), nr. 6/2020 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR), nr. 22/2021 (JR), nr. 26/2021 (JR), nr. 28/2021 (JR) dhe nr. 31/2021 (JR).

trupi gjykues nuk konstaton të gjejnë vend pretendimet e subjektit të rivlerësimit për anshmëri të Komisionit e, aq më pak, qëllim për të disfavorizuar atë me problematika të paqena. Në përmbushje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur akte shkresore në datën 24.02.2020, bashkë me shpjegimet për rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në vijim, në afate të ricaktuara prej Komisionit në përgjigje të kërkesave të tij për zgjatje të afateve kohore për sigurim të provave. Fakti që nga përcjellja e raportit për rezultatet e hetimit administrativ, në datën 11.02.2020, për një periudhë kohe mbi 4 muaj, deri në datën 26.06.2020, Komisioni ka pranuar të gjitha kërkesat e subjektit për kohë shtesë për paraqitje të provave në përmbushje të barrës së provës, për rrjedhojë, pretendimi për anshmëri të Komisionit vlerësohet i pabazuar.

11.2.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni pa asnjë argument faktik dhe ligjor ka shmangur zhvillimin e hetimit administrativ për disa nga çështjet më të rëndësishme të këtij procesi. Komisioni nuk i është drejtuar me kërkesë shoqërisë {***} për të hedhur dritë mbi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vëllezërit e tij i kanë transferuar shuma të mëdha kursimesh nga puna në emigracion. Nga aktet në fashikullin e ILDKPKI-së, trupi gjykues vëren se me deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një shkresë të Unionit Financiar Tiranë, datë 28.10.2016². Pavarësisht kësaj, në kuptim të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës, materializuar në ligjin nr. 84/2016, nenin 32, pika 1, qartësuar në detaj edhe në Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së³, është subjekti i rivlerësimit që ka detyrimin të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues ose në kuptim të pikës 2, nenit 32 të këtij ligji të vërtetojë pamundësinë objektive për disponimin e tij. Rreth tre muaj përpara dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit është informuar nga Unioni Financiar Tiranë se, sipas legjislacionit kombëtar, konkretisht udhëzimit nr. 2, datë 03.08.2012, të Komisionerit për Mbrojtjen e të dhënave Personale, pika 12/b,⁴ që parashikon detyrimin për ruajtjen e të dhënave për një afat pesëvjeçar për institucionet jobankare, nuk mund të japë informacionin e kërkuar. Subjekti nuk ka adresuar asnjë kërkesë për të siguruar këtë informacion nga burime të tjera e për të përmbushur detyrimet ligjore. Në këto kushte, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka shmangur hetimin administrativ dhe ky informacion duhet të kërkohet prej Kolegjit vlerësohen të pabazuara.

11.2.3. Ndërsa lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shmangie të hetimit administrativ nga Komisioni, lidhur me kërkesën e tij për t'iu drejtuar ALUIZNI-t, Lezhë, me qëllim verifikimin e dokumenteve në dosjen e legalizimit të shtesës së apartamentit në Lezhë, në pronësi të vëllait L. N., trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk qëndron. Nga aktet në dosjen gjyqësore, provohet se Komisioni ka kërkuar nga ALUIZNI⁵ çdo informacion që

² Shkresë e Unionit Financiar Tiranë, nr. {***} prot., datë 28.10.2016, "Kthim përgjigje", për kërkesën e subjektit, datë 14.10.2016, për dhënie informacioni mbi dokumente transferimi parash nëpërmjet {***}, kryer në periudhën 1995-2004.

³ Udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, i datës 10.10.2016, në pikën 21 parashikon: "Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaramit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë".

⁴ Udhëzimi nr. 2, datë 03.08.2012, i Komisionerit për Mbrojtjen e të dhënave Personale "Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar", pika 12/b parashikon: "Të dhënat personale të klientëve mbahen deri në pesë vjet pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare me klientin. Në përfundim të periudhës 5-vjeçare banka fshin këto të dhëna nga skedarët dhe nga sistemi kompjuterik dhe fizik bankar".

⁵ Shkresë nr. {***} prot., datë 26.02.2019, e Komisionit.

disponohet në këtë institucion dhe ato në varësi të tij, lidhur me ndërtimet e deklaruara, regjistruara për procedura legalizimi në emër të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes, si dhe prindërve të tyre. Drejtoria e ALUIZNI-t, në përgjigje, për shtesën anësore në pallatin ekzistues 5 kate, ka konfirmuar pajisjen me lejendërtimi të z. Z. N. N. (babai i subjektit) e të tjerë, ndërsa Drejtoria e ALUIZNI-t Lezhë ka vënë në dispozicion dokumentacionin e legalizimit të këtij ndërtimi. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për të siguruar vetë deklaratën noteriale të vëllait të tij L. N., duke iu drejtuar me kërkesë ALUIZNI-t dhe paraqitur në Komision dokumentacionin e përcjellë prej tij. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka shmangur zhvillimin e hetimit administrativ, duke pasur qëllim moszbardhjen e së vërtetës, gjendet i pabazuar.

11.3. Subjekti i rivlerësimit pretendoi për trajtim diskriminues, interpretim ndryshe të ligjit, vlerësim të ndryshëm të fakteve në vendimin objekt shqyrtimi, në raport me atë të mbajtur nga Komisioni ndaj subjekteve të tjerë të rivlerësimit. Trupi gjykues e vlerëson të pambështetur këtë pretendim, duke theksuar se në kuptim dhe zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit mbështetet në faktet dhe rrethanat specifike për secilën rast. Moskitimi nga Komisioni në vendim i praktikave të mëparshme të tij, sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, nuk përbën shkak për të pretenduar interpretim ndryshe të ligjit dhe as për vendim të paarsyetuar, në aspektin formal dhe në përmbajtje. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 71, datë 02.12.1998: *“[...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike, të ketë zgjidhje të njëjlojta nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethana, faktorë, motive apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëjlojta. [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të bëjë me mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre [...]”*. Me konsideratë qëndrimin e Kolegjit⁶, një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të pretenduar vlerësim të ndryshëm të fakteve në vendimin dhënë ndaj tij në raport me atë të mbajtur ndaj subjekteve të tjerë të rivlerësimit. Pretendimet e subjektit, lidhur me procesin e tij të rivlerësimit dhe provat e administruara në fashikujt e Komisionit, iu nënshtruan vlerësimit nga ana e trupit gjykues të Kolegjit, referuar shkaqeve të ankimit lidhur me themelin, duke qenë objekt i këtij vendimi dhe duke gjetur pasqyrim në paragrafët vijues të tij. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit prezumohet i ezauruar nëpërmjet kontrollit të kryer në Kolegj, të pasqyruar në këtë vendim.

11.4. Lidhur me pretendimet se gjatë hetimit administrativ, në mënyrë sistematike, Komisioni nuk i ka dhënë lehtësi të nevojshme kohore për të realizuar mbrojtje efektive, vënie në presion kohe të panevojshëm apo moslejimit në seancë për të shpalosur në detaje kundërshtimet ndaj gjetjeve të relatuar, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore është shprehur se *“[...] vlerësoj e çmoj maksimalisht mirëkuptimin e*

⁶ Shih vendimet e Kolegjit nr. 20/2021 (JR) dhe nr. 19/2022 (JR).

Komisionit që më ka dhënë kohë për të vazhduar prapë përsiatjen [...] ⁷, pra, subjekti pranon të kundërtën e sa pretenduar në ankim.

11.4.1. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikuj, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka pranuar disa herë kërkesat e subjektit të rivlerësimit për shtyrje afati: (i) si për dhënie kohe shtesë për sigurimin e dokumentacionit, duke e shtyrë afatin e caktuar në datën 22.02.2020, disa herë përgjatë një periudhe rreth katërmujore; ashtu dhe (ii) për shtyrje të seancës dëgjimore, caktuar në datën 30.07.2020, për në datën 06.08.2020, duke mos krijuar kështu asnjë pengesë që subjekti i rivlerësimit të përmbushte detyrimet që rrjedhin nga procesi i rivlerësimit.

11.4.2. Lidhur me pretendimin për vënie nën presion të kohës, subjekti i rivlerësimit referoi kërkesën e Komisionit në datën 30.12.2019, rreth orës 15:30, në prag të ndërrimit të viteve, për të paraqitur deri në datën 10.01.2020 dokumentacionin e paraqitur për vëllezërit dhe kunatën gjatë qëndrimit në Angli të legalizuar me vulë apostile. Si njohës i ligjit, subjekti i rivlerësimit ka qenë i qartë për formën ligjore të paraqitjes së dokumenteve të huaja, sipas nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile. Edhe për këtë rast, pas komunikimit me subjektin e rivlerësimit se institucionet në Angli janë të mbyllura deri në datën 7 janar, Komisioni ricaktoi një afat tjetër deri në datën 20.01.2020, për rrjedhojë pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar.

11.4.3. Subjekti i rivlerësimit pretendoi për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, por edhe shprehet se *kam paraqitur prova dhe shpjegime të gjata dhe shteruese dhe parashtrimi im verbal (kryesisht monolog) në seancë dëgjimore ka zgjatur rreth 9 orë*. Edhe për shkak të kohëzgjatjes, por edhe nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, trupi gjykues konstaton se subjekti ka shpjeguar pa u kufizuar lidhur me provat dhe rezultatet e hetimit administrativ. Ndërhyrjet e kryesueses, në jo pak raste, për të kthyer fokusin në shpjegimin e provave dhe të qëndrimit ndaj konstatimeve të Komisionit, kanë pasur qëllim dhe kanë kontribuar në efektivitetin e të drejtës së subjektit për t'u dëgjuar, pa e cenuar në asnjë rast atë. Gjithashtu, pyetjet e drejtuara subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore, dëshmojnë se atij i është krijuar mundësia për të shpjeguar dhe për të dhënë detaje lidhur me çështjen dhe ka pasur kohën e mjaftueshme për t'u dëgjuar, për t'u shprehur dhe analizuar çdo pretendim të tij, me fjalë të tjera, seanca dëgjimore ka përmbushur qëllimin konform ligjit.

11.5. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është cenuar nga mungesa e një vendimmarrje formale për kërkesat e tij për riçelje të hetimit për të tria kriteret e rivlerësimit, nga caktimi i seancës dëgjimore pa kryer një relativitet dhe analizim të provave, nga pamjaftueshmëria e kohës, nga data e zhvillimit të seancës dëgjimore në datën e shpalljes së vendimit, për leximin, marrjen në analizë e më pas në konsideratë të prapësimeve të tij.

11.5.1. Nga aktet në dosje gjyqësore, trupi gjykues evidenton se pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe ripërsëritur kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ, si dhe vlerësimin për dy kriteret e tjera, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, konkretisht në datat

⁷ Shih procesverbalin e seancës dëgjimore, faqe 55.

24.02.2020, 26.02.2020 dhe 23.03.2020. Në përgjigje të kërkesave, Komisioni e ka njoftuar se do të vendosë për rihapjen ose jo të hetimit edhe për dy kriteret e tjera, pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit përfundimtar. Në kushtet kur në përmbushje të barrës së provës subjekti vijonte të depozitonte prova dhe kërkesa për shtyrje afati për paraqitje të provave të tjera, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për një vendimmarrje formale lidhur me kërkesat për ricelje të hetimit të paraqitura, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar, pasi Komisioni me të drejtë ka vijuar me hetimin administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë mbi bazën e provave të sjella edhe nga subjekti.

11.5.2. Në çelje të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë paraprake për riçeljen e hetimit administrativ duke argumentuar se mbyllja e hetimit administrativ me një kriter është në kundërshtim me ligjin dhe paragjyqese, dhe se me shpjegimet dhe provat e shumta të paraqitura prej tij nuk ka arsye që seanca dëgjimore të zhvillohet vetëm për një kriter. Komisioni, sikundër ishte shprehur se do ta vlerësonte kërkesën në harmoni me provat e tjera, përpara dhënies së vendimit përfundimtar, në datën 08.08.2020, ka disponuar me vendim të ndërmjetëm, duke vendosur mospranimin e saj. Në vendimin objekt ankimi, Komisioni ka arsyetuar se [...] *pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike të datës 06.08.2020, vlerësoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij dhe në vijim të rezultateve të hetimit, arriti në përfundimin se provat e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, për kriterin e pasurisë, kishin nivelin e provueshmërisë dhe subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për disa prej tyre. Trupi gjykues, referuar parashikimeve të pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 16, të seksionit III, të vendimit nr. 3, datë 17.07.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vlerëson se kur provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendimi mund të merret bazuar vetëm në atë kriter vlerësimi.*

11.5.3. Lidhur me pretendimin për mungesë të kohës fizike për Komisionin për leximin, marrjen në analizë e më pas në konsideratë të prapësimeve të subjektit, nga aktet në dosje, trupi gjykues konstaton se: (i) shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, prej 83 faqesh dhe 45 dokumente në cilësinë e provës, janë paraqitur në datën 24.02.2020; (ii) dokumentet mbi të ardhurat e familjes së vëllait për vitet 2007-2014 dhe shpjegimet përkatëse mbi to janë paraqitur në datën 26.02.2020; (iii) dokumente të tjera në cilësinë e provës janë paraqitur në datat 04.03.2020 dhe 23.03.2020; ndërsa (iv) në datën 26.06.2020 janë paraqitur të përkthyer e legalizuar dokumente të paraqitura dhe më herët. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se periodha kohore prej gjashtë muajsh, nga 24.02.2020 deri në ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore më 06.08.2020, ka qenë më se e mjaftueshme për Komisionin për t'u njohur me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

11.6. Lidhur me pretendimin për mohim të së drejtës së mbrojtjes efektive, pasi Komisioni pa asnjë argument ligjor ka refuzuar kërkesat e përsëritura të tij për vënien në dispozicion të gjithë akteve të ndodhura në dosje, përfshirë ato që i përkasin kriterit të figurës dhe vlerësimit profesional, trupi gjykues çmon të theksojë se procesi i rivlerësimit për subjektin Aleks Nikolli është kryer vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në kushtet kur ai nuk provoi të kundërtën e barrës së provës për këtë kriter, mosnjohja me aktet e administruara në kuadër të dy kriterëve të tjera nuk afekton ligjshmërinë e procedurës së ndjekur nga Komisioni. Shprehja

në mendimin e pakicës së Komisionit, të cilës i referohet subjekti i rivlerësimit se *ishte kryer një hetim i thelluar dhe mungonte vetëm kristalizimi i gjetjeve*, nuk ka asnjë efekt në vendimmarrjen e Komisionit.

11.7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se rrëzimi i kërkesës së tij për njohjen me komunikimin dhe përcjelljen tek ONM-ja të të gjithë përgjigjeve, shpjegimeve, kërkesave, prapësimeve të tij përfshirë dhe ato të seancës dëgjimore, si dhe njohja e mendimeve apo opinioneve të tyre, nëse ka pasur të tilla, pamundëson realizimin e një mbrojtje efektive. Sipas subjektit të rivlerësimit në një proces të rregullt ligjor nuk mund të ketë asgjë sekrete, e cila mund të ketë shërbyer për të marrë një vendim ndaj një subjekti.

11.7.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje se në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, procesi i rivlerësimit mbështetet nga ONM-ja nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së procesit. Nga aktet procedurale, që Komisioni i ka vënë në dispozicion me kërkesë të tij⁸, subjekti rezulton të jetë vënë në dijeni të pranisë së vëzhgueses ndërkombëtare në të gjithë hapat proceduralë të ndjekur nga Komisioni, përfshirë shqyrtimin e shpjegimeve dhe provave të tij, sikundër edhe të kërkesave për riçelje të hetimit administrativ. Referuar procesverbaleve të mbledhjeve, rezulton që ato janë zhvilluar në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, më konkretisht: (i) në datën 10.02.2020, ku u vendos përfundimi i hetimit paraprak vetëm për kriterin e pasurisë; (ii) në datën 27.07.2020, ku u vendos përfundimi i hetimit administrativ dhe caktimi i seancës dëgjimore; dhe (iii) në datën 08.08.2020, pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të administruar në funksion të hetimit administrativ dhe shqyrtimit të provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore dhe u mor vendimi për mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për riçelje të hetimit administrativ për dy kriteret e tjera.

11.7.2. Këto momente procedurale dëshmojnë se vëzhguesja ndërkombëtare, në ushtrim të rolit të saj, ka qenë në dijeni të plotë të shpjegimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga subjekti. Gjithashtu, nga procesverbali i seancës dëgjimore, trupi gjykues konstaton se subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar, jo vetëm në kuadër të barrës së e provës, por ka risjellë në vëmendje shpjegimet e dhëna përmes pyetësorëve gjatë hetimit administrativ. Përkthyesit profesionistë të angazhuar pranë organeve të rivlerësimit, ashtu edhe pranë ONM-së, garantojnë korrektësinë e përkthimit të materialeve në formë të shkruar. Për rrjedhojë, pretendimet, lidhur me kontrollin e saktësisë së përkthimit, vlerësohen nga trupi gjykues si përpjekje për të krijuar shkaqe ankimi, në favor të pretendimeve për kundërshtimin e vendimit të Komisionit. Për më tej, adresimi prej vëzhgueses ndërkombëtare i pyetjeve për subjektin në seancë dëgjimore, lidhur me provat e paraqitura prej tij, përjashtojnë dyshime për njohjen prej saj të gjendjes së akteve të administruara.

11.8. Lidhur me pretendimin se vendimi i Komisionit nuk është i arsyetuar mjaftueshëm në standarde të pranueshme, për shkak të mosdhënies përgjigje të pretendimeve të tij, sikundër nuk është arsyetuar mospranimi i kërkesës për çelje të hetimit administrativ për kriterin profesional dhe atë të figurës, shkaqe që e bëjnë procesin administrativ të zhvilluar ndaj tij, nul.

⁸ Referoju shkresës nr. {***} prot., datë 22.04.2021, të Komisionit, me lëndë “Kthim përgjigje”.

11.8.1. Trupi gjykues vëren se vendimi objekt shqyrtimi plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, në strukturë, si dhe në përmbajtje të pjesës hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. Edhe lidhur me marrëdhënien e huapërdorjes reciproke, pa shpërblim, me vëllain e tij, për të cilën analizohet gjerësisht në vijim, në vendimin objekt shqyrtimi janë referuar rrethanat e çështjes, gjetjet e hetimit administrativ, barra e provës kaluar subjektit, janë cituar shpjegimet e subjektit, sikundër janë pasqyruar dhe analizuar provat e paraqitura prej tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit është thelbësisht i paarsyetuar.

11.8.2. Nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerëson se përfundimet janë rezultat i interpretimit të dispozitave ligjore në rrethanat e faktit dhe jo pasojë e moskonsiderimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti. Në konsideratë të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese se *sidoqoftë detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (shih vendimin nr. 36, datë 26.07.2011, të Gjykatës Kushtetuese)*. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (shih vendimin nr. 3, datë 23.01.2014, të Gjykatës Kushtetuese)⁹, trupi gjykues vlerëson se pretendimi se në vendim nuk i është dhënë përgjigje sa pretenduar prej tij, lidhet me vlerësimin që Komisioni u ka bërë fakteve dhe provave në raport me kërkesat ligjore.

11.8.3. Për sa u përket akteve të paraqitura nga subjekti në mbështetje të deklarimeve të tij, deklaratat noteriale të vëllezërve dhe prindërve të bashkëshortes, Komisioni ka arsyetuar lidhur me vlerën e kufizuar provuese të tyre në procesin e rivlerësimit. Mënyra sesi Komisioni ka interpretuar dhe vlerësuar provat nuk e bën inekzistent apo të cenueshëm procesin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të tyre, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, për administrim formal të provave, vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar.

11.9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi duhet të konsiderohet i pavlefshëm, për shkak se për një pasuri objekt vlerësimi relatori ka paraqitur si vendim të shumicës vetëm opinionin e tij personal.

11.9.1. Trupi gjykues konstaton se lidhur me huapërdorjen e ndërsjellë (reciproke pa shpërblim), mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij L. N., situata paraqitet si vijon: subjekti i jep në huapërdorje vëllait të tij apartamentin me sipërfaqe 147,8 m² në {***}, Lezhë dhe pjesën e pandarë të tokës bujqësore përreth me sipërfaqe 700 m² për t'u përdorur prej tij dhe familjes dhe merr në huapërdorje pa shpërblim apartamentin e banimit (me shtesë anësore) në pronësi të vëllait, ndodhur në qytetin e Lezhës, e përbërë nga tri pasuri (për shkak të mënyrës së ndryshme të fitimit mbi to dhe kohës së regjistrimit të tyre në ZVRPP). Komisioni në vendim ka arritur në përfundimin se *krijohet bindja se apartamenti kryesor dhe dy shtesat me sipërfaqe respektive 82,13 m², 68,26 m² dhe 78,06 m², pavarësisht se janë të regjistruara në emër të shtetasit L. N. janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit*. Në mendimin paralel, lidhur

⁹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 24.03.2014.

me kualifikimin ligjor të kësaj çështje, është mbajtur qëndrim se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të vëllait L. N., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke theksuar që ky kualifikim nuk afekton në qëndrimin pro vendimmarrjes për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Aleks Nikolli¹⁰. Në mendimin e pakicës, anëtari i trupit gjykues nuk është shprehur lidhur me këtë huapërdorje. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues, në ushtrim të kompetencës së parashikuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson të ndalet së pari në dhënien e orientimit për Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

Në kushtet e pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përdorim reciprok të sendeve në huapërdorje, pa përfitim, specifikisht në kushtet e marrëdhënies së posaçme, hetimi është orientuar nga nevoja për të verifikuar marrëdhënien reale të subjektit të rivlerësimit me apartamentin e vëllait të tij. Nëse gjatë kontrollit të pasurisë së vëllait, në përdorim të subjektit të rivlerësimit, nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (pasi për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi, për mosshpjegim bindshëm të burimeve të ligjshme të vëllait për krijimin e pasurisë, subjektit të rivlerësimit, do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit.

Sa i përket pretendimit të subjektit, për pasqyrimin e një përfundimi që nuk ka marrë shumicën e votave në vendim, trupi gjykues e vlerëson si shkelje procedurale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 57, pika 4, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për të vlerësuar nëse karakteri dhe rëndësia e shkeljes së konstatuar passjell pavlefshmëri të vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues analizoi situatën bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Pjesa V-të, Kreu I, seksioni III “Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korigjimi i aktit administrativ”. Ky seksion, qëllimi i përgjithshëm i të cilit është kryesisht për t’i dhënë zgjidhje akteve administrative me defekte, të meta, nis me nenin 107, i cili konkretizon parimin e ligjshmërisë të parashikuar në nenin 4 të po këtij ligji dhe përcakton kërkesat kryesore që duhet të përmbushë akti administrativ që të jetë korrekt e, konkretisht, kompetencën e organit publik për nxjerrjen e aktit, interpretimin dhe zbatimin e çdo rregulli të këtij ligji, në përputhje me parimet kryesore të tij, si dhe respektimin e rregullave procedurale si parakusht për zbatimin e të drejtës materiale. Ndërsa në nenin 108¹¹, që parashikon për pavlefshmërinë absolute të aktit, koncepti *në kundërshtim të hapur dhe flagrant* kërkon më shumë sesa thjesht mosrespektim të ndonjë dispozite ligjore. Duke marrë parasysh pasojat juridike të pavlefshmërisë absolute, parashikuar në nenin 110 e vijues të ligjit të sipërcituar,

¹⁰ Referohu mendimit paralel të anëtares B. B., shprehur: [...] kryesisht në konsideratë të pamundësisë financiare të konstatuar, për të investuar në blerjen e apartamentit dhe ndërtimin e dy shtesave anësore, nga shtetasit L. dhe F. N., çmoj se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 [...] lidhur me kualifikimin ligjor të një çështje specifike objekt vlerësimi, si një ndër shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, por që nuk afekton qëndrimin pro vendimmarrjes për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit, për shkaqet e tjera, të subjektit të rivlerësimit, z. Aleks Nikolli.

¹¹ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në nenin 108 të titulluar “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”, parashikon: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: (a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjisllacionit në fuqi lidhur me: (ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose (iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit [...]”.

koncepti në kundërshtim të hapur dhe flagrant kërkon ekzistencën e një të mete jashtëzakonisht të rëndë dhe serioze, që mund të përkufizohet si një e metë në kundërshtim flagrant me rendin ligjor dhe vlerat themelore në të cilat bazohet rendi juridik, rrjedhimisht të jetë krejtësisht e patolerueshme nëse akti do të sjellë pasojat e synuara. Në çështjen objekt shqyrtimi, kjo shkelje nuk cenon vlefshmërinë e aktit në kontekstin ligjor të vendimmarrjes, për sa zhvillimi i hetimit administrativ është detyrim i buruar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Shkelja e konstatuar nuk ka të bëjë me themelin e vendimit, por për njërën prej pasurive të vlerësuara në këtë vendim. Në funksion të kryerjes së vlerësimit të drejtë ligjor të gjendjes faktike të bazuar në ligj e prova, në ushtrim të kompetencave të tij, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi shqyrtimin e kësaj çështje në seancë gjyqësore publike, në prani të subjektit të rivlerësimit, e cila u zhvillua në datën 12.07.2023. Sa më sipër, trupi gjykues, me këtë vendim të ndërmjetëm, shëroi të metën e konstatuar në Komision dhe i garantoi subjektit të rivlerësimit procesin e rregullt ligjor, sipas nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

11.10. Lidhur me pretendimet e subjektit sa i përket tejkalimit të afatit të arsyetimit të vendimit prej Komisionit, trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i këtij afati nuk ka bërë të cenueshëm vendimin e Komisionit, si dhe nuk ka cenuar të drejtën e subjektit të ushtrojë ankim ndaj këtij vendimi¹².

11.11. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vendosur në kundërshtim me nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke përfunduar procesin e rivlerësimit vetëm me një kriter. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se në lexim harmonik të parashikimeve të nenit 4, pika 2, fjalia e fundit, e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se vendimi mund të merret edhe bazuar në një prej kriterëve të rivlerësimit, për sa kohë nga hetimi administrativ kryesisht rezultojnë probleme për të cilat ky ligj parashikon masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, përmbysja e barrës së provës nga subjekti lidhur me kriterin e hetuar, që në rastin konkret nuk ka ndodhur, kushtëzon çeljen e hetimit për dy kriteret e tjera. Për këtë fakt ka mbajtur qëndrim edhe GjEDNj-ja, si dhe Kolegji ka qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij, duke e konsideruar të drejtë qëndrimin e Komisionit për këtë aspekt procedural dhe të rregullt përfundimin e procesit të rivlerësimit, që përfshin një apo dy kriteret vlerësimi¹³. Në kushtet kur faktet dhe rrethanat për kriterin e vlerësimit të pasurisë kanë rezultuar përcaktuese dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimin, trupi gjykues çmon se kjo situatë procedurale nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi, nuk demonstroi paragjykim të trupit gjykues të Komisionit apo paracaktim të vendimit dhe vlerëson se subjektit të rivlerësimit nuk i janë cenuar të drejtat e tij. Lidhur me pretendimin e subjektit për krijimin e një shtate kolapsi procedural në rastin e përfundimit të procesit të rivlerësimit vetëm me një kriter, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji, kur pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, ka prishur vendimin e Komisionit dhe ka urdhëruar vazhdimin e kryerjes së procesit të rivlerësimit

¹² Shih vendimin e Kolegjit nr. 19, datë 10.06.2022 (JR), paragrafi 14.1.

¹³ Shih vendimet e Kolegjit nr. 3/2018 (JR), nr. 6/2018 (JR), nr. 1/2019 (JR), nr. 12/2019 (JR), nr. 15/2019 (JR), nr. 29/2019 (JR), nr. 3/2022 (JR) dhe nr. 23/2022 (JR).

edhe për kriterin e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale¹⁴. Për rrjedhojë, trupi gjykues i vlerëson pretendimet e subjektit të rivlerësimit të tejkaluara.

11.12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në vlerësimin e kriterit të pasurisë, analizat dhe interpretimet e Komisionit janë jo objektive, paragjyquese, tendencioze, në interpretim të gabuar të frymës dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit dhe të standardeve ekonomike, fiskale, kontabël dhe tregtare, gjetjet kryesore fokusohen në analizimin e jetës ekonomike-financiare të individëve që nuk janë subjekte të rivlerësimit, madje për periudha që ai nuk ka qenë gjyqtar ose për persona që nuk ka pasur asnjë lidhje (vjehtë e ardhshëm të tij).

11.12.1. Lidhur me pasurinë ndërtesë 3 kate në {***}, Lezhë, e krijuar në vitin 2003, në të cilin subjekti zotëron apartamentin me sipërfaqe 148 m² dhe në kushtet kur subjekti pretendon se burimi i krijimit të kësaj pasurie është me të ardhurat e vëllezërve dhe kunatës së tij, passjell detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie. Lidhur me marrëdhënien e huapërdorjes reciproke, pa shpërblim, mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij L. N. dhe bashkëshortes së tij F. N., trupi gjykues vlerëson se qartësimi i situatës nëse kjo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit ka diktuar analizimin e rrethanave faktike dhe mundësive financiare të ligjshme të personave të sipërcituar, për krijimin e kësaj pasurie.

11.12.2. Ndërsa, lidhur me blerjen e pasurisë njësi me sipërfaqe 12 m², në Lezhë, në emër të bashkëshortes së subjektit, Komisioni ka hetuar lidhur me mundësitë financiare të prindërve të saj, M. G. dhe L. G., megjithëse nuk i ka kualifikuar *persona të tjerë të lidhur*. Trupi gjykues e vlerëson të bazuar shtrirjen e hetimit për mundësitë financiare të prindërve të bashkëshortes, bazuar në sa argumentuar nga Komisioni në vendim se: (i) pasuria njësi me sipërfaqe 12 m² është deklaruar si pasuri më vete nga bashkëshortja e subjektit me burim krijimi të ardhurat nga familja e saj. Në këtë situatë faktike, bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të saj; (ii) kjo pasuri është produkt i një transaksioni të drejtpërdrejtë me subjektin e rivlerësimit; (iii) shumat e përfituara nga subjekti përmes këtij transaksioni janë përdorur gjatë martesës në kryerjen e një investimi të ri. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se lidhur me hetimin e mundësive financiare të prindërve të bashkëshortes së tij, qëndrimi i subjektit ka qenë jokonseguent. Fillimisht, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat e shtetasve të sipërcituar. Pas kalimit të barrës së provës, ai dhe personi i lidhur (bashkëshortja) nuk arrijnë të provojnë me dokumentacion ligjor krijimin e shumës 3.200.000 lekë për krijimin e kësaj pasurie. Subjekti ka pretenduar se kjo barrë prove vjen në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, duke e potencuar këtë qëndrim edhe me deklarin se pasuritë e krijuara nga bashkëshortja para se të lidhnin martesë mbeten pasuri të saj dhe nuk ndikojnë në pasuritë e krijuara prej tij gjatë ushtrimit të detyrës. Mungesa e konsistencës në qëndrime krijon bindjen se ngritja e pretendimeve ka ardhur si pasojë e rezultateve të hetimit të disfavorshme për subjektin. Komisioni nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi lidhur me mjaftueshmërinë financiare për krijimin e kësaj pasurie të bashkëshortes (prindërve të saj), megjithatë subjekti edhe për këtë çështje pretendoi për interpretim të gabuar të frymës dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit, sikundër gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, sipas tij. Trupi gjykues vlerëson se për sa nga

¹⁴ Shih vendimin e Kolegjit nr. 14/2021 (JR).

rrethanat faktike është dëshmuar se nga veprimet e subjektit dhe pranimin e tyre nga bashkëshortja e ardhshme janë krijuar të ardhura të përdorura për krijimin e pasurive gjatë martesës, shtrirja e hetimit për mjaftueshmërinë financiare për burimin e krijimit të pasurisë së bashkëshortes jashtë martesës vjen në funksion të kontrollit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive gjatë martesës. Për rrjedhojë, arsyetimin e Komisionit e vlerëson të drejtë, hetimin e zhvilluar prej tij të bazuar në ligj dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të pabazuara.

11.13. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka mbajtur parasysh parimin e fajësisë, pasi edhe në eventualitetin e mosprovimit të mundësive financiare të të afërmeve të tij për të justifikuar pasuritë e tyre në standardet e sanksionuara nga ligji, duhet të provonte fajësinë e tij për këto fakte, për sa ai nuk ka pasur si ta dijë apo ndikojë në sigurimin dhe ruajtjen e dokumentacionit provues të të ardhurave të ligjshme të tyre.

11.13.1. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se procesi i rivlerësimit është i karakterit administrativ, pa qasje me procesin penal ku gjen aplikimi "*parimi i fajësisë*". Kuadri kushtetues dhe ligjor që normon dhe rregullon këtë proces parashikon qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të paraqitur të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive ose për t'i vërtetuar institucioneve të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Në këtë kuadër, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të përmbushë detyrimet ligjore si sipërcituar lidhur me të ardhurat e vëllait L. N. për periudhën 2000-2003. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

11.14. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se fokusimi në kundërshtimin e mundësive të një kohe ekonomike të largët, për të cilën nuk ka asnjë mundësi objektive për të gjetur dokumentacion shkresor, cenon edhe parimin e sigurisë juridike, pasi pasuritë e subjektit i janë nënshtruar një kontrolli të imtësishëm nga ILDKPKI-ja, që ka konsideruar si të mjaftueshme provat dhe shpjegimet e tij, siç është edhe raporti i sjellë në Komision. Konsiderimi si të pamjaftueshme të provave për vitet 1990-2010, kur shumë institucione vendase dhe të huaja nuk ruajnë më dokumente, është i paarsyeshëm, i padrejtë dhe i pabazuar në ligj.

11.14.1. Kolegji në jurisprudencën e tij, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur qëndrim se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht kohës kur ka ndodhur ky fakt, nëse lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Për rrjedhojë, kryerja e kontrollit të pasurive, pavarësisht kohës së krijimit të tyre, është zbatim i kuadrit kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit, qëllimit të këtij procesi për rikthimin e besimit të publikut te drejtësia dhe nuk mund të pretendohet apo interpretohet si fokusim në mundësi ekonomike të një kohe të largët. Ligjvënësi, në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar edhe për rastet e pamundësisë

objektive për të disponuar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, por kjo situatë nuk ka rezultuar e provuar për subjektin e rivlerësimit.

11.14.2. Lidhur me pretendimet për cenim të parimit të sigurisë juridike, për sa pasuritë i janë nënshtruar një kontrolli të imtësishëm nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues konstaton se në raportin e ILDKPKI-së, institucion me rol ndihmës në procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, është konkluduar për deklaram jo të saktë në përputhje me ligjin, vlera të dyshimta shitblerje të pasurive të paluajtshme dhe mosdeklarim të transaksioneve bankare si person i autorizuar, pasqyruar në pikën 4 të këtij vendimi, dëshmojnë të kundërtën e pretendimeve të subjektit. Në konsideratë të qëndrimit të GjEDNj-së [...] *vlerësimi i pasurisë manifeston specifika të caktuara, ndryshe nga hetimet e zakonshme disiplinore, të cilat do të kërkonin një shkallë më të lartë fleksibiliteti për shtetin e paditur për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rikthimit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e një niveli të lartë integriteti që pritet nga anëtarët e gjyqësorit. Kjo është edhe më e vërtetë në kontekstin shqiptar ku verifikimi paraprak i deklaratave të pasurisë nuk kishte qenë veçanërisht efektiv [...]. Së fundmi, mund të jetë, gjithashtu, një çështje interpretimi se kur saktësisht një shkelje e veçantë disiplinore mund të ketë ndodhur në këtë kontekst, domethënë, nëse në kohën kur është blerë fillimisht pasuria ose në një pikë të mëvonshme, në kohën kur pasuria është deklaruar në një deklaratë periodike. Në të njëjtën kohë, një fleksibilitet i tillë nuk mund të jetë i pakufizuar dhe implikimet për sigurinë juridike dhe të drejtat e një kërkuesi sipas nenit 6/1 të Konventës duhet të konsiderohen rast pas rasti¹⁵, saktësia e deklaratimeve të subjektit, si dhe mjaftueshmëria dhe provueshmëria e provave të paraqitura prej tij, ezaurohen nëpërmjet kontrollit të kryer në Kolegj, të pasqyruar në këtë vendim.*

11.15. Hetimi dhe analiza e kryer nga Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit nuk mban në konsideratë parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit, parashikuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, duke braktisur tërësisht vlerësimin e punës së tij si gjyqtar dhe duke u fokusuar në analizimin e jetës ekonomiko-financiare të të afërmeve të tij, duke tejkalluar në këtë mënyrë përcaktimet kushtetuese dhe ligjore për objektin dhe qëllimin e këtij procesi.

11.15.1. Siç është shtjelluar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹⁶, bazuar në nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se kriteret e vlerësimit të pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale janë të pavarura nga njëra-tjetra. Secili prej neneve të sipërcituar të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, pavarësi e cila pasqyrohet në përcaktimet e masave disiplinore, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Në përmbushje të qëllimit të procesit të rivlerësimit, që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, për secilin prej kriterëve të rivlerësimit duhet të përjashtohet ekzistenca e rrethanave për të cilin parashikohet dhënia e masës disiplinore, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur për kriterin e pasurisë, Komisioni ka konkluduar se provat kanë nivelin e provueshmërisë dhe subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për pjesën më të madhe të rezultateve të hetimit, pretendimi

¹⁵ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafi 349.

¹⁶ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit nr. 19/2019 (JR) dhe nr. 29/2020 (JR).

për vlerësim të aktivitetit profesional, në konsideratë të parimit të objektivitetit, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar. Lidhur me kryerjen e analizës financiare për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur, në funksion të vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues nuk gjen asnjë shkak për të cilin të pretendohet për tejkalim të objektit dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit.

11.16. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se moszbatimi i parimit të proporcionalitetit, për vlerësime që s'kanë të bëjnë me të, por me të afërm të tij, për një periudhë që ai nuk ka qenë gjyqtar dhe masa disiplinore për shkarkimin e tij nga detyra, nuk ka si të jetë e domosdoshme për arritjen e qëllimit të reformës. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit¹⁷, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se parimi i proporcionalitetit është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqet procesi i rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i rivlerësimit dhe Komisioni është i autorizuar të peshojë dhe të balancojë interesat e përfshira deri në atë masë që ligji nr. 84/2016 jep hapësirë për opsione të ndryshme, por nuk është i autorizuar t'i vlerësojë disa prej tyre më ndryshe se të tjerat pa ndonjë arsye objektive. Për pasuritë nën hetim administrativ, duke mos përfshirë atë lidhur me huapërdorjen reciproke, trupi gjykues konstaton se konkluzionet e Komisionit referojnë lidhur me saktësinë e deklarimeve të subjektit për mjaftueshmërinë financiare për krijimin e pasurive, të deklaruara prej tij. Komisioni nga vlerësimi tërësor i kriterit të pasurisë, mbështetur në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se sipas përfundimeve të arritura masa disiplinore është proporcionale.

11.17. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ligjvënësi, duke njohur shkallën e lartë të informalitetit të vendit, ka vendosur të sanksionojë standardin e moslejimit të justifikimit më shumë se dyfishi i pasurisë me të ardhura të ligjshme të dokumentuara. Kolegji ka jurisprudencë të konsoliduar për interpretimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, që secili prej paragrafëve të këtij neni normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, me elemente specifike dhe të pavarura, të cilat zberthehen në përcaktimet e masave disiplinore, sipas pikave 1 dhe 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ndër to, respektivisht, i pari lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme, ndërsa tjetri me pamjaftueshmërinë e deklarimit të pasurisë. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se deklarimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme është kufiri ndarës për efekt të masës së shkarkimit nga detyra nuk është i mbështetur në ligj.

11.18. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka zbatuar gabim nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke i ngarkuar në mënyrë të padrejtë barrën e provës, ndërkohë që duhej të provonte vetë pamundësinë financiare të pretenduar prej tij. Në respektim të kësaj dispozite, Komisioni duhej të merrte prova të cilat provojnë pamundësinë e subjektit nën hetim dhe jo të kufizohet të pamundësia objektive e subjektit për të siguruar prova.

11.18.1. Aneksi i Kushtetutës, në nenin Ç, pika 5, parashikon se *barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin*

¹⁷ Shih vendimet e Kolegjit nr. 2/2020, datë 27.02.2020; nr. 20/2020, datë 08.09.2020 dhe nr. 36/2020, datë 16.12.2020.

penal, i cili materializohet në ligjin nr. 84/2016, nenin 52, pika 2, ku parashikohet se *Komisioni ose Kolegji i Apelimit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën*. Lidhur me përmbushjen e detyrimit kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, ligji nr. 84/2016 parashikon edhe detyrimin e subjektit të rivlerësimit për t'i vërtetuar organeve të rivlerësimit pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion, normuar në pikën 2, neni 32, të tij. Subjekti pretendoi se Komisioni nuk ka paraqitur argument përse nuk e konsideron të vërtetë se e ka të pamundur për të siguruar në ndonjë lloj forme të ligjshme dokumente shkresore për persona të tjerë, për fakte të ndodhura jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën përpara se ai të fillonte detyrën si gjyqtar. Në vendimin objekt shqyrtimi është analizuar se *Komisioni vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për njohjen e të ardhurave të vëllezërve nga emigracioni në Greqi në shumën 3.000.000 lekë në vitet 1992 – 1998/1999, nuk qëndron për sa kohë nuk është depozituar dokumentacion ligjor për të provuar të ardhurat nga puna në shtetin grek*. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji në vendimin e datës 17.12.2018¹⁸, ku përcaktohet që për të ardhurat e realizuara nga emigracioni të provohet me dokumentacion justifikues ligjshëmëria e krijimit të tyre dhe pagimi i detyrimeve tatimore për to, sipas pikës 3, të nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Në lidhje me kërkesën e subjektit për aplikimin e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, për të ardhurat e vëllezërve nga puna në emigracion në Greqi, në shumën 3.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pamundësinë objektive për të disponuar dokumentacionin që do të justifikonte ligjshëmërinë e krijimit të të ardhurave të tyre. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se arsyetimi i Komisionit është i drejtë, i bazuar në ligj, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, për të cilën vetë subjekti, në shkaqe të ankimit analizuar më lart, pretendon se përbën precedent që duhet zbatuar.

11.19. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili duke marrë shkas nga informacione mediatike rreth dyshimeve mbi procedurën e emërimit dhe plotësimin e kriterëve ligjore të disa anëtarëve të Komisionit dhe se Kolegji në respektim të nenit 6 të KEDNj-së, sa i përket *gjykatës së krijuar me ligj*, duhet të analizojë, qoftë edhe kryesisht, respektimin e standardeve të vendosura nga GjEDNj-ja, në lidhje me anëtarët e Komisionit, që kanë dhënë vendimin objekt ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 3, datë 06.02.2023, paragrafi 10.1.11.

- 12.** Me ankimin dhe parashtrimet e depozituara në Kolegji, subjekti i rivlerësimit kërkoj administrimin në cilësinë e provës të disa akteve shkresore ¹⁹. Në këndvështrimin e dispozitës

¹⁸ *Vendimi i Kolegjit nr. 12/2018 (JR), subjekti i rivlerësimit B. D..*

¹⁹ *Bashkëlidhur ankimit, subjekti paraqiti:*

- a) *Ekstrakt historik për të dhënat e subjektit «person fizik», të QKB-së, për subjektet: A. N., A. K., E. M., E. N. dhe V. M..*
- b) *Screen shot telefoni, në të parin ora 13:36, pasqyrohet numri {***}, koha dhe kohëzgjatja e thirrjeve telefonike: ora 11:55 thirrje dalëse 43 min 58 sek; ora 11:05 thirrje dalëse 25 min 28 sek - në të dytin ora 07:31 pasqyrohet tekst, në gjuhën angleze, i titulluar «general enquiries» me informacionin se për çdo pyetje të përgjithshme lidhur me llogarinë tuaj, telefononi në {***}, linjat janë të hapura në oraret 8 -16:00, nga e hëna në të premte dhe 9-17:00 të shtunën dhe të dielën, për telefonata nga UK dhe nga jashtë.*

-
- c) Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. {***}, datë 11.09.2019, me të cilin është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit B. M. për kryerjen e veprës penale “vjedhja”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.
- ç) Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme me kusht dhe rezervë, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.03.2017, palë shitëse L. Xh., palë blerëse personi fizik “F. Gj.”, me objekt shitjen e një njësie me sip. 95 m² në lagjen “{***}”, Lezhë, bashkëlidhur: certifikatë për vërtetim pronësie dhe HTR të datës 17.05.2006; kartela e pasurisë së paluajtshme datë 29.03.2017; mandatpagesa bankare; certifikatë familjare e palës shitëse; si dhe ekstrakti QKB-së i palës blerëse.
- d) Kopje të noteruara me nr. {***} rep., datë 01.05.2021, të akteve si vijon:
- (i) kontratë pjesëtimi pasuri e paluajtshme nr. {***}, datë 23.10.2020, me palë L. G., V. M. dhe B. K., për ndarjen e vullnetshme të pasurisë me sipërfaqe totale 33,1 m, Lezhë (Z. K. {***}, volumi {***}, faqe {***}, nr. pasurie {***});
- (ii) kontratë shitje pasuri e paluajtshme, nr. {***}, datë 04.12.2020, palë shitëse V. M. dhe A. M., palë blerëse B. K., me objekt shitjen e pasurisë njësi me sipërfaqe 9 m², Lezhë (Z. K. {***}, volumi {***}, faqe {***}, nr. pasurie {***}), bashkëlidhur si pjesë përbërëse e saj, rezultojnë: certifikatë për vërtetim pronësie dhe HTR; kartela e pasurisë; mandatpagesa; dhe certifikata familjare të palëve;
- (iii) kontratë shitje pasuri e paluajtshme, nr. {***}, datë 24.11.2020, palë shitëse V. M. dhe A. M., palë blerëse L. G., me objekt shitjen e pasurisë njësi me sipërfaqe 2 m², Lezhë (Z. K. {***}, volumi {***}, faqe {***}, nr. pasurie {***}), bashkëlidhur si pjesë përbërëse e saj, rezultojnë: certifikatë për vërtetim pronësie dhe HTR; kartela e pasurisë; mandatpagesa; dhe certifikata familjare të palëve;
- (iv) kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme, nr. {***}, datë 02.11.2020, dhuruese B. K. dhe V. M., pranues i dhurimit L. G., me objekt marrëveshjen mes bashkëpronareve (palë në kontratën e dhurimit), për kalimin pa shpërblim te pranuesi i dhurimit, të pasurisë 8,8 m² (truall+ndërtesë) Lezhë, bashkëlidhur si pjesë përbërëse e saj, vërtetim nga dokumenti hipotekor dhe HTR;
- (v) kontratë shkëmbimi nr. {***}, datë 17.11.2020, me palë L. G./ M. G. dhe B. K. /S. K., me objekt marrëveshjen mes palëve për këmbimin e pronësive mbi pasuritë: me sip. totale 5,5 m² e zënë nga 5,5 m² ndërtesë, me nr. {***}, në pronësi të palës së parë; me sip. totale 5,5 m², kati i parë, me nr. {***} në pronësi të palës së dytë. Bashkëlidhur si pjesë përbërëse e kontratës, rezultojnë: certifikata e pronësisë/ vërtetim nga dokumenti hipotekor, HTR; certifikata familjare dhe ID të palëve;
- (vi) shkresë e ASHK, nr. {***} prot., datë 07.01.2021, drejtuar A. D. M., për vërtetimin mbi aplikim për legalizim të ndërtimit pa leje;
- (vii) kontratë bashkëpunimi për sipërmarrje në ndërtim, nr. {***}, datë 20.11.2020, me palë shoqëria “{***}” dhe B. N., me objekt punime rikonstruksioni në pasurinë njësi me sip. 12 m², me nr. {***}, Lezhë;
- (viii) relacion teknik informues mbi punimet që do të kryhen punime rikonstruksioni në pasurinë nr. {***}, Z. K. {***}, Bashkia Lezhë, porositës B. N.;
- (ix) lejdërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni nr. {***} prot., datë 31.12.2020, lëshuar nga Bashkia Lezhë, për zhvillues B. N., NIPT/NID {***}; subjekt ndërtues “{***}” ShPK;
- (x) vendim i Kryetarit të Bashkisë Lezhë, nr. {***}, datë 31.12.2020, për miratimin e lejes së ndërtimit për rikonstruksion pa ndryshim funksioni;
- (xi) kontratë qiraje njësi shërbimi, datë 11.01.2021, qiradhënëse B. N. (G.), qiramarrës I. G., me objekt dhënien me qira të pasurisë nr. {***}, sip. 12 m², Lezhë;
- (xii) printime ortofotosh digjitale; si dhe
- (xiii) 21 fotografi.
- Bashkëlidhur parashtrësive, subjekti paraqiti:
- a) video të ceremonisë së martesës së motrës në vitin 2003, zhvilluar në mjediset e shtëpisë 3-katëshe në {***}, Lezhë, si dhe video të kësaj shtëpie realizuar në vitin 2019;
- b) video e martesës së vëllait të bashkëshortes së tij dhe dëshmi martese, lëshuar nga {***} nr. prot. {***}, datë 30.05.2023;
- c) vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, datë 31.10.2022;
- d) certifikatë regjistrimi pronësie, lloji i pasurisë “njësi”, sipërfaqe 37,8 m², Z. K. {***}, nr. pasurie {***}, Lezhë, në emër të B. N. së bashku me fragment të hartës kadastrale (me vulë elektronike, datë lëshimi 22.11.2020);
- e) vërtetim i ASHK-së, drejtoria vendore Lezhë, së bashku me fragment të hartës kadastrale (me vulë elektronike, datë lëshimi 24.11.2022);

ligjore që normon pranimin e provave të reja në gjykimin administrativ të apelit, konkretisht nenit 47²⁰ të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se pa fajin e tij nuk ka mundur të paraqesë disa prej këtyre akteve shkresore gjatë hetimit administrativ në Komision, duke mos kënaqur kështu kërkesat e këtij neni. Analizuar nën dritën e parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016 se *kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë*, trupi gjykues i vlerëson të panevojshme dhe të parëndësishme në raport me faktet që subjekti synon të provojë për zgjidhjen në themel të çështjes nga Kolegji.

C. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

*Lidhur me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 147,8 m², K. {***}, në {***}, Lezhë*

13. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimet se: (i) subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 4.133.466 lekë, për mbulimin e shpenzimeve, krijimin e pasurive dhe ndërtimin e banesës trekatëshe në {***}, Lezhë, për vitin 2003; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 4.622.624 lekë për ndërtimin e banesës trekatëshe në {***}, Lezhë, në vitet 2003-2004²¹; (iii) subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime jo në përputhje me ligjin, me qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore në caktimin e një çmimi jo real në kontratën e shitblerjes të vitit 2004, ndërmjet tij dhe të vëllait K. N..
14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke i konsideruar ato të pabazuara dhe duke pretenduar se: (i) vlerësimi i provave dhe rrethanave nuk është kryer sipas parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, pasi Komisioni nuk ka konsideruar rrethanat

f) *kërkesë e H. G. për çelje të trashëgimisë ligjore për të ndjerën G. G., datë 21.07.2011 dhe certifikatë vdekje për të ndjerën G. G., datë vdekje 26.04.2010, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Lezhë, datë 19.07.2011;*

g) *vendim nr. {***}, datë 25.07.2011, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Lezhë, me objekt: “Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerën G. G., vdekur më datë 26.04.2010”;*

h) *vendim nr. {***}, datë 25.07.2011, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Lezhë, me objekt “Ndreqje gabimi në shkrim te vendimi gjyqësor civil nr. {***}, datë 25.07.2011”;* si dhe

i) *dokumente në format elektronik (CD) të referuara në ankim me linkun përkatës.*

²⁰ *Neni 47, i ligjit nr. 49/2012, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.*

²¹ *Për këtë konkluzion, Komisioni me poshtëshënim ka sqaruar: vlera totale e banesës trekatëshe është në shumën 10.152.588 lekë (200.000 lekë blerë në vitin 2001 toka dhe shtëpia e vjetër + 9.757.440 lekë vlera e situacionit në vitin 2003 + 195.148 lekë taksa e infrastrukturës paguar në 2003). Shuma e kontributeve për ndërtimin e banesës me të ardhura të ligjshme të L. N. dhe K. N., të marra në konsideratë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit janë në shumën 5.529.964 lekë (4.784.714 lekë kontributi i K. N. 2000-2004 dhe 745.250 lekë kontributi i L. N. në vitin 2003). Subjekti dhe personat e tjerë të lidhur me të kanë mungesë burimesh të ligjshme për ndërtimin e banesës private 3-katëshe në shumën 4.622.624 lekë (10.152.588 lekë - 5.529.964 lekë).*

Kontributi i K. N. është 4.784.714 lekë (për periudhën 2000-2003 ai ka kontribuar me 21.022 GBP x 193,12 = 4.059.769 lekë + për vitin 2004 ka kontribuar me 4.057 paund x 178.69 = 724.945 lekë).

Kontributi i L. N. është 745.250 lekë (nga kursimet me të ardhura të ligjshme prej 6.492 GBP dhe pas blerjes së tokës në shumën 2.633 GBP, ka pasur 3.859 GBP si kontribut për ndërtimin e banesës 3-katëshe, 3.859 GBP x 193,12 = 745.250 lekë).

objektive dhe shpjegimet e subjektit për këtë pasuri të krijuar përpara se të emërohej gjyqtar në tetor 2004 dhe për të cilën asnjëherë nuk ka deklaruar që është pronar i saj; (ii) pas përfundimit të procedurave formale, regjistrimi i pronës në emrin e tij në gusht 2003 është bërë për shkaqe tërësisht objektive, në kushtet kur vëllezërit ishin në emigrim në Angli, motrat të martuara apo në pritje për t'u martuar, si dhe prindërit në pamundësi për të ndjekur procedurat e regjistrimit; (iii) nga momenti i blerjes së pronës fillestare në vitin 2001, në truallin e së cilës është ndërtuar banesa 3 (tre) kate dhe deri në kalimin formal të 50% të ndërtesës tek i vëllai K. N., pas kthimit të tij nga Anglia më datë 15.09.2004, ka vepruar në mirëbesim si përfaqësues i vëllezërve dhe jo si titullar i të drejtave. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës, si gjyqtar provizor për kryerjen e stazhit profesional të vitit 2003, e ka deklaruar pasurinë dhe pjesën e tij të pandarë prej 50 %; (iv) vëllai K. N. nuk është *person tjetër i lidhur*, prandaj burimi i krijimit të dy kateve, në pronësi të tij, nuk duhen bërë pjesë e analizës financiare të subjektit.

14.1. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të administruara në fashikuj, evidenton kronologjinë e veprimeve të subjektit të rivlerësimit si titullar i të drejtave, konkretisht: në datën 21.09.2001, ka blerë pasurinë fillestare, me sipërfaqe totale 950 m², nga ku 200 m² truall dhe 150 m² ndërtesë dhe ka regjistruar titullin e pronësisë në ZVRPP-në Lezhë, në datën 21.09.2001. Në gusht të vitit 2003 ka lidhur kontratë sipërmarrje me shoqërinë “{***}” ShPK, për ndërtim të objektit privat 3 kate (pas shembjes së ndërtesës së vjetër) dhe si investitor ka kryer procedurat pranë organeve kompetente vendore. Këto të fundit, me shkresën e datës 22.07.2004, kanë dërguar pranë ZVRPP-së Lezhë dokumentacionin për regjistrimin e objektit *shtëpi private 3 (tre) kate, {***}*, me pronar Aleks Z. Nikolli, regjistrim i kryer sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP-ja Lezhë më datë 23.08.2004. Me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 15.09.2004, subjekti i rivlerësimit si pronar i vetëm i pasurisë i shet vëllait të tij K. N. ½ të pasurisë, pjesë e pandarë, kundrejt vlerës 200.000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Me kontratën e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme nr. {***}, datë 11.07.2011, pasuria është ndarë mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait K. N.. Sipas kësaj kontrate, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar pronësia e katit të II-të të banimit me sipërfaqe 147,8 m² dhe në bashkëpronësi të detyrueshme ka mbetur sipërfaqja funksionale e objektit 3 (tre) kate, truall me sipërfaqe 250 m², si dhe 50 % bashkëpronësi të sipërfaqes 700 m² tokë arë, pronë e deklaruar si pasuri e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*.

14.2. Referuar provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ²², ka rezultuar i provuar fakti që periudha e përfundimit të ndërtimit të katit të parë të objektit është me datë 13.09.2003, ndërsa për dy katet e tjera kishin mbetur pa u kryer vetëm punimet e rifiniturës, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e gjyqtarit për kryerjen e stazhit profesional, si pjesë e programit të Shkollës së Magjistraturës, më datë 21.10.2003²³.

14.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron: “*Tokë bujqësore 700 m² e ndodhur në fshatin {***}, Lezhë, e blerë në sipërfaqen 950 m², së bashku me shtëpinë e*

²² Subjekti ka paraqitur si provë materialin filmik të ceremonisë së martesës së motrës së tij, zhvilluar në ambientet e ndërtesës 3-katëshe, objekt gjykimi, në datat 13.09.2003 dhe 14.09.2003.

²³ Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 3983, datë 21.10.2003, emëruar gjyqtar provizor për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë.

vjetër më datë 21.09.2001 [...] dhe pas pjesëtimit me vëllain K. në natyrë të shtëpisë së re më datë 11.07.2011, kjo sipërfaqe toke bujqësore është ndarë nga sipërfaqja e truallit të banesës prej 250 m². Sot kjo sipërfaqe toke bujqësore është në bashkëpronësi në tërësi me pjesë të pandara me vëllain K.. Burimi i krijimit edhe të kësaj pasurie është puna në emigracion, në Greqi dhe Angli e vëllait K. dhe e vëllait të madh L. me bashkëshorten e tij F.. [...] Shtëpia e vjetër bashkë me sipërfaqen prej 950 m² tokë më datë 21.09.2001 është blerë në shumën 200.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”.

14.4. Në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtëpi banimi trekatëshe e ndërtuar në vitin 2003 me sipërfaqe 146 m² për kat. Vlera: 10.000.000 lekë; pjesa që zotëron 50%, ndërtuar me leje ndërtimi nr. {***}, datë 06.08.2003, të KRRt-së Shëngjin. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “Persona të tjerë të lidhur me pasuri të përbashkët [...]”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar prindërit dhe vëllezërit L. N. e K. N. me shënimin *me banim të përkohshëm në Angli*. Sa më sipër, trupit gjykues i rezulton se subjekti ka deklaruar bashkëpronësinë e tyre në pasurinë e sipërcituar dhe pjesën në zotërim të tij. Kalimi i 50 % të pasurisë tek i vëllai K. N., menjëherë pas kthimit të tij nga Anglia në vitin 2004, në më pak se një muaj pas regjistrimit në ZVRPP, të pasurisë ndërtesë 3 (tre) kate, përkundrejt një çmimi prej 200.000 lekësh, krahasuar me vlerën e dokumentuar të ndërtimit prej 10.000.000 lekësh, provon, gjithashtu, për rregullimin e bashkëpronësisë mes subjektit dhe vëllait K. N..

14.5. Për të provuar bashkëpronësinë e të vëllait në këtë pasuri dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***}, datë 21.03.2015, të vëllait K. N., në të cilën ka deklaruar se burimi i pasurive ndërtesë 3-katëshe, truallit dhe tokës arë përreth kësaj ndërtese, janë të ardhurat nga puna e tij dhe e vëllait L. N., në emigracion. Sipas marrëveshjes mes tyre, L. N. dhe K. N. do të kontribuonin financiarisht me kursimet nga puna në emigrim, ndërsa Aleks Nikolli do të kujdesej për menaxhimin dhe materializimin e tyre në ndërtimin e banesës për familjen, marrëveshje e formalizuar me kontratë noteriale për shitjen e ½ pjesë të ndërtesës dhe tokës dhe pjesëtimit në natyrë në vitin 2011. Kjo deklaratë noteriale, e cila nuk është bërë gjatë procesit të rivlerësimit, në vlerësim të trupit gjykues mbështet pretendimet e subjektit lidhur me burimet e krijimit të pasurisë ndërtesës 3 (tre) kate, truall me sipërfaqe 250 m² nën të, si dhe tokës bujqësore me sipërfaqe 700 m².

14.6. Me konsideratë qëndrimin e Kolegjit²⁴ në jurisprudencën e tij, lidhur me përfshirjen në objektin e kontrollit nga organet e rivlerësimit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, pavarësisht nëse rezulton që krijimi i tyre të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të detyrës, në funksion të identifikimit të subjekteve që janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive për të cilat nuk mund të justifikohet ligjërisht burimi i tyre, trupi gjykues, në përfundim të analizës në paragrafët më sipër, bazuar në parimin e objektivitetit, vlerëson si vijon.

14.7. Në kushtet kur subjekti ka vepruar si titullar i të drejtave për këtë pasuri, prej vitit 2001, kohë kur të ardhurat e tij kanë qenë modeste si gjyqtar provizor dhe nuk provohet ndonjë

²⁴ Shih vendimin (JR) nr. 19/2019, pika 22.16, të Kolegjit.

veprimtari tjetër prej së cilës të ketë siguruar të ardhura, mundësitë e tij për të kontribuar financiarisht për krijimin e kësaj pasurie janë të papërfillshme. Ndërkohë në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës të vitit 2003, që ka vlerën e provës në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti provon se në pronësi personale legjitime të tij nuk është e gjithë ndërtesa bashkë me truallin nën të me sipërfaqe 250 m² dhe tokën bujqësore përreth me sipërfaqe 700 m², sikundër analizon Komisioni në vendim. Gjithashtu, deklarata noteriale e vëllait K. N. e administruar nga ILDKPKI-ja në vitin 2015, përpara fillimit të procesit të rivlerësimit, si dhe dokumentacioni i administruar në fashikuj për të ardhurat nga emigracioni i vëllezërve të tij, provojnë se subjekti ka vepruar si titullar i të drejtave për këtë pasuri i kushtëzuar nga shkaqe objektive. Për sa sipërsyrtuar, provohet se subjekti vetëm ka menaxhuar të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni duke vepruar si përfaqësues i tyre, por nuk ka investuar financiarisht në ndërtimin e objektit në shqyrtim e, për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson pretendimin e subjektit të bazuar.

14.8. Në përfundim të kontrollit të ushtruar ndaj analizës financiare të kryer në Komision, trupi gjykues vlerësoi se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit K. N. dhe L. N. kishin të ardhura të ligjshme për ndërtimin e ½ pjesë të godinës 3-katëshe, në {***}, Lezhë, e regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit Aleks Nikolli në vitin 2004.

14.9. Në kushtet kur pasuria është krijuar me të ardhura e vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se veprimet juridike mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij K. N. në vitin 2004 nuk kanë pasur për qëllim shmangien e detyrimeve tatimore, por saktësimin e të drejtave mbi pasurinë e përbashkët.

14.10. Në çfarëdo rrethane, pavarësisht problematikave të hasura, lidhur me pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit apo burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, trupi gjykues çmon se pesha e tyre nuk mund të ketë ndikim në procesin e rivlerësimit, konsideruar rrethanat e rastit, krijimit të pasurisë përpara fillimit të detyrës prej subjektit të rivlerësimit, si dhe për shkak të të ardhurave nga emigracioni të vëllezërve të tij.

*Lidhur me kontratë sipërmarrje me shoqërinë “{***}” ShPK, për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe totale 124,9 m², nga të cilat 84,3 m² sipërfaqe e shfrytëzueshme (13,5 m² sipërfaqe të përbashkëta dhe 27,1 m² ballkon), në {***}, Tiranë*

- 15.** Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka vendosur: [...] burimi financiar i përdorur nga subjekti për blerjen e këtij apartamenti, që është në pjesën më të madhe të tij nga shitja e njësisë në Lezhë më 03.08.2009, për çmimin 3.200.000 lekë, duket që nuk është burim i besueshëm [...]. Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe konkluzionet e mësipërme, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm që shuma prej 1.250.000 lekësh, kthyer prej shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, të përbëjë penaltitetin që kjo shoqëri i ka paguar atij si rezultat i mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale, duke krijuar bindjen se kjo shumë përbën ligjërim të disa burimeve financiare të pidentifikuara të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet veprimeve fiktive në marrëveshje me shoqërinë ndërtuese.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzionet e Komisionit, për këtë pasuri, janë të pabazuara në ligj e fakte dhe vijnë në kundërshtim me logjikën ekonomike dhe vetë praktikën e Komisionit. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit ngre në ankim pretendimet në vijim: (i) pavarësisht mospërcaktimit të llogaritjes dhe pagimit të penaltetit nga sipërmarrësi, kontrata e sipërmarrjes parashikon zgjidhjen prej tij në mënyrë të njëanshme dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas legjislacionit civil, i cili garanton të drejtat e tij për shpërbllim në rast dëmtimi nga subjekti kontraktor; (ii) në vlerë nominale, shuma e kthyer nga sipërmarrësi “{***}” ShPK në vitin 2018 është më e madhe se ajo e paguar prej tij në vitin 2014, qartësisht në shumë aspekte, përfshirë atë ekonomiko-financiar, ai ka qenë i vetmi i dëmtuar; (iii) aktmarrëveshja për zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes, datë 08.05.2018, parashikon për mënyrën e përllogaritjes së penaltetit, përcaktimi nominal i secilit zë të komponentëve do të ishte i pakuptimtë dhe i panevojshëm për qëllimet e kontratës; (iv) pamundësia apo moskorrektësia e sjelljes së shoqërisë në shlyerjen e detyrimit monetar ndaj tij nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi; (v) në funksion të evidentimit të dystandardësisë së Komisionit, duhet sjellë në vëmendje se shtrirja e kontrollit të veprimit juridik për zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes së këtij apartamenti në vitin 2018 është tej afatit të periudhës së rivlerësimit.

16.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për këtë pasuri: *“Kontratë sipërmarrje me sipërmarrës “{***}” ShPK për ndërtimin e një apartamenti në {***}, (ish) Komuna Kashar, Tiranë, me sipërfaqe totale 124,9 m², nga të cilat 84,3 m² sipërfaqe e shfrytëzuar e apartamentit, 13,5 m² sipërfaqe e përbashkët dhe 27,1 m² ballkone, e lidhur më datë 14.11.2014 me afat përfundimi deri më 28.09.2017 [sipas afatit të lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 24.09.2014, të KRRt-së Kashar]. Nuk është lidhur akoma kontrata përfundimtare e kalimit të pronësisë. Vlera e kësaj kontrate në kohën e lidhjes ka qenë 5.200.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %”*. Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) kursimet nga puna si gjyqtar; (ii) interesat bankare nga depozitat bankare të shumave të kursyera; (iii) shitja më datë 03.08.2009 e njësisë me sipërfaqe 12 m².

16.2. Në deklaratën e interesave privatë 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kontratë porositje/sipërmarrje për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe totale 124,9 m² nga sipërmarrësi “{***}” ShPK, në {***}, Komuna Kashar. Vlera e deklaruar e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes 5.200.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %”*. Lidhur me burimin e ligjshëm, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *pagesa e sipërmarrësit për ndërtimin e këtij apartamenti është bërë nga shuma e kursimeve të mia të mbledhura ndër vite të depozituara pranë Veneto Bank, Lezhë (Kam mbyllur llogarinë e kursimit dhe kam bërë transfertën e shumës firmës “{***}” ShPK).*

16.3. Nga dokumentacioni i dosjes nënshtruar debatit gjyqësor, trupit gjykues i ka rezultuar e provuar se subjekti ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2014, me porositës Aleks Nikolli dhe sipërmarrës/investitor shoqërinë “{***}” ShPK, për ndërtimin e apartamentit me sipërfaqe totale 124,9 m² (2+1), me adresë, {***}, Komuna Kashar, Tiranë. Çmimi për blerjen e këtij apartamenti sipas kontratës së sipërmarrjes është përcaktuar në vlerën 5.200.000 lekë, parashikuar të paguhet në favor të shoqërisë brenda datës 17.11.2014. Ndërsa më datë 08.05.2018, kontrata e sipërmarrjes rezultoi e zgjidhur nëpërmjet aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., *“Për zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes nr.*

{***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2014”. Në pikën 2 të kësaj aktmarrëveshje parashikohet se [...] palët bien dakord që sipërmarrësi “{***}” ShPK t’i paguajë porositësit Aleks Nikolli për zgjidhjen e kësaj kontrate shumë prej 6.400.000 lekësh.

16.4. Gjatë hetimit administrativ në Komision, i pyetur mbi arsyet e zgjidhjes së kontratës së sipërmarrjes, subjekti ka shpjeguar se nga shoqëria nuk janë respektuar detyrimet e kontratës sa i përket regjistrimit të apartamentit në ZVRPP-në Tiranë dhe në të njëjtën kohë apartamenti i porositur i ishte dhënë një familje tjetër për banim.

16.5. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank” ShA, përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 15.03.2019, trupit gjykues i rezulton që prej datës 26.06.2018 deri më 03.09.2018 kjo llogari të jetë kredituar me shumë 6.450.000 lekë me përshkrimin *zgjidhje kontrate nr. {***} rep., nr. {***} kol.*, rrjedhë e zgjidhjes së kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2014.

16.6. Në referim të deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me burimin e shumës 5.200.000 lekë, e cila ka shërbyer për porositjen e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes më shoqërinë “{***}” Sh.p.k., trupi gjykues mori në analizë dokumentacionin ligjor lidhur me krijimin e pasurisë “njësi” me sipërfaqe 12 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Lezhë, vlera e shitjes e së cilës ka shërbyer për krijimin e vlerës 5.200.000 lekë. Ka rezultuar se: (i) me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2008, me palë shitëse V. H. dhe blerës Aleks Nikolli, ky i fundit ka blerë njësinë me sipërfaqe 12 m² kundrejt vlerës 1.200.000 lekë; (ii) me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 03.08.2009, me palë shitëse Aleks Nikolli dhe blerës B. G. [bashkëshortja e ardhshme e subjektit], subjekti i rivlerësimit e tjetërson këtë pasuri në vlerën 3.200.000 lekë. Nga analizimi i këtyre kontratave, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit një vit pas blerjes së kësaj pasurie, periudhë përgjatë së cilës ai nuk e ka përdorur këtë pasuri, ia shet bashkëshortes së ardhshme në shumë 3.200.000 lekë, pra, 2.000.000 lekë më tepër, ndërkohë që nuk kishte kryer asnjë investim në të. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit për dyshime mbi caktimin e një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes së lidhur midis subjektit dhe B. G.. Këtë vlerësim e përforcon dhe fakti i mungesës së ekzistencës së një gjurme bankare mes subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij të ardhshme, si dhe depozitimi *cash* nga subjekti i shumës një ditë pas formulimit të aktit noterial, rreth tre herë më i lartë se çmimi i blerjes së kësaj pasurie në vitin 2008, si dhe mungesa e interesit të familjes së personit të lidhur bashkëshortes së subjektit, duke mos e përdorur atë për një periudhë të gjatë. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm e, për rrjedhë, vendosi të mos përfshijë këtë shumë në mesin e të ardhurave të ligjshme, si burim krijimi për vlerën 5.200.000 lekë, e cila ka shërbyer për porositjen e apartamentit të mësipërm.

16.7. Trupi gjykues, pasi analizoi provat shkresore në fashikuj dhe u njoh me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, në linjë me Komisionin, vlerëson se shuma 1.250.000 lekë përbën ligjërimin e disa burimeve financiare të pidentifikuara të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet veprimeve fiktive në marrëdhënie me shoqërinë ndërtuese. Ky konkluzion vjen si pasojë se subjekti i rivlerësimit nuk e provoi me dokumentacion ligjor

se shuma e kthyer prej 1.200.000 lekësh të ishte në formën e penalitetit, pasi në kontratën e sipërmarrjes nuk ishte e përcaktuar llogaritja dhe mënyra e pagimit të penalitetit nga sipërmarrësi. Penaliteti prej 1.200.000 lekësh i pretenduar prej subjektit, edhe në rastin më të mirë, nuk justifikohet dhe është dukshëm më i lartë nga përfitimet nga qiraja. Edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se pas përfundimit të ndërtimit të apartamentit shoqëria ka lejuar që në këtë apartament të banojë një familje tjetër mbeti i paprovuar.

16.8. Në lidhje me burimin financiar të deklaruar nga subjekti për blerjen e apartamentit nga shoqëria “{***}” ShPK, trupi gjykues vlerëson se vlera e përfituar nga shitja e njësisë me sipërfaqe 12 m² nuk duhet të përfshihet si e ardhur e ligjshme për krijimin e shumës 5.200.000 lekë, e cila ka shërbyer për porositjen e apartamentit. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj shume, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit ka pasur qëllim ligjërimitin e të ardhurave financiare të paidentifikuara përmes shitjes në datën 03.08.2009 të njësisë me sipërfaqe 12 m² në qytetin e Lezhës, nëpërmjet një veprim fiktiv të bashkëshortes së tij, njësi e cila ishte blerë prej subjektit një vit më parë më 31.07.2008 dhe nuk ishte vënë në përdorim prej tij gjatë vitit që ai gëzoi pronësinë mbi të, sikundër nuk është vënë në përdorim nga bashkëshortja e tij, për disa vite pas fitimit të pronësisë.

Lidhur me huapërdorje e ndërsjellë (reciproke pa shpërblim)

17. Komisioni, për këtë huapërdorje, arriti në përfundimin se kontrata e huapërdorjes së ndërsjellë, e lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të, shtetasve L. N. dhe F. N., nuk është e besueshme dhe, për rrjedhojë, krijohet bindja se apartamenti kryesor dhe dy shtesat me sipërfaqe respektive 82,13 m², 68,26 m² dhe 78,06 m², pavarësisht se janë të regjistruara në emër të shtetasit L. N., janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.
18. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se: (i) klasifikimi i marrëdhënies së huapërdorjes reciproke si hua është e pabazuar në dispozitat e Kodit Civil, në ligjin nr. 84/2016, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit; (ii) marrëdhënia e huapërdorjes është krijuar në vitin 2013, bazuar në interesin reciprok të palëve dhe prej saj ai nuk ka pasur përfitim të njëanshëm; (iii) nuk janë vlerësuar drejt arsyet, veprimet dhe mundësitë e vëllait të tij për krijimin e pasurisë apartament dhe dy shtesave anësore në qytetin e Lezhës; (iv) përfundimi vetëm i relatorit nuk ka vlerën e vendimit të Komisionit dhe, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, nuk mund të bëhet objekt i shqyrtimit në apel.
19. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton si vijon.

19.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi *huapërdorje e ndërsjellë (reciproke dhe pa shpërblim)*, duke i dhënë në huapërdorje, vëllait L. apartamentin tim në {***} me sipërfaqe 147,8 m² dhe pjesën e pandarë të tokës bujqësore përreth 700 m² për t’u përdorur prej tij dhe familjes së tij (për pushime kur të ndodhet në Shqipëri) dhe marrja prej meje në huapërdorje pa shpërblim e apartamentit të banimit (me shtesë anësore) në pronësi të tij, e ndodhur në qytetin e Lezhës, e përbërë nga tre pasuri (për shkak të mënyrës së ndryshme të fitimit të pronësive mbi to dhe kohës së regjistrimit të tyre në ZRPP) me sipërfaqe respektive 82,13 m², 68,26 m² dhe 78,06 m². Burimi i krijimit apartamentit në Lezhë është nga

puna e vëllait dhe e bashkëshortes në Angli që nga vitit 1999 deri aktualisht, duke blerë pasurinë e parë në një pallat të ndërtuar para viteve '90 dhe legalizuar dy shtesat e tjera anësore.

Vlera e blerjes më datë 13.10.2012 nga vëllai, i pjesës së parë të apartamentit me sipërfaqe 82,13 m² është 7.000.000 lekë ndërsa për ndërtimin e shtesës (dy apartamente bashkë me sipërfaqe respektive 68,26 m² dhe 78,06 m²), sipas deklarimeve të tij ka shpenzuar rreth 5.500.000 lekë. Pas rivlerësimit apartamenti me 68,26 m² është regjistruar me vlerë 3.822.560 lekë, ndërsa 78,06 m² është regjistruar me vlerë 4.379.200 lekë. Pjesa takuese: 0%.

20. Trupi gjykues lidhur me këtë pasuri, sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, referuar dhe kontratës së huapërdorjes së ndërsjellët reciproke pa shpërblim, çmon të analizojë fillimisht marrëdhënien juridike të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri duke i dhënë njëkohësisht edhe përgjigjen pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përjashtim të vëllait nga klasifikimi i tij si person tjetër i lidhur, sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 dhe mospërfshirjen e pasurisë së tij në analizë sipas kërkesave të këtij ligji.
21. Nga analizimi i kontratës së huapërdorjes reciproke, datë 11.10.2016, mes palëve kontraktuese, huadhënës/huamarrës, përkatësisht Aleks Nikolli dhe L. N., me objekt, marrjen në huapërdorje reciproke të banesave në pronësi të palëve sipas kontratës, për t'u përdorur për banim pa shpërblim, rezulton se Aleks Nikolli i jep vëllait të tij L. N. në huapërdorje apartamentin me sipërfaqe 147,8 m² dhe pjesën e tij për pasurinë "tokë arë" me sipërfaqe 700 m² të ndodhura në {***}, Lezhë dhe L. N. i jep në huapërdorje vëllait Aleks Nikolli, apartamentin e tij të banimit ndodhur në lagjen "{***}", rruga "{***}", Lezhë, i ndarë në tre pasuri: apartament me sipërfaqe 82,13 m²; apartament me sipërfaqe 68,26 m²; si dhe apartament me sipërfaqe 78,06 m².

21.1. Me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit dhe konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri në qytetin e Lezhës, si pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon, në kuadër të parashikimit në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, të bëjë verifikimin mbi mundësinë financiare me burime të ligjshme të vëllait të subjektit të rivlerësimit L. N. dhe bashkëshortes së tij.

Nga analizimi i akteve të dosjes dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupit gjykues i rezulton se:

21.1.1. Apartamenti i banimit me sipërfaqe 82,13 m², ndodhur në lagjen "{***}", rruga "{***}", Lezhë, rezulton i blerë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit L. N., me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.10.2011, në vlerën 7.000.000 lekë, të likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale.

21.1.2. Për likuidimin e çmimit të apartamentit gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në periudhën gusht-tetor të vitit 2010 është dhënë pa u dokumentuar kapari në shumën 1.000.000 lekë dhe diferenca prej 6.000.000 lekësh është likuiduar në vitin 2011, me nënshkrimin e kontratës së shitjes më datë 13.10.2011.

21.1.3. I pyetur mbi burimin e krijimit të shumave për blerjen dhe mobilimin e këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kryesisht kanë shërbyer depozitat në emër të nënës së tij D. N., në shumat prej 40.000 euro dhe 20.000 euro, të tërhequra ²⁵ prej tij, si person i autorizuar²⁶ me autorizim të brendshëm të bankës, përkatësisht në datat 03.08.2010 dhe 03.03.2011.

21.1.4. Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një adresë tjetër vendbanimi, apartament të ndodhur në lagjen “{***}”, Lezhë, duke shpjeguar gjatë hetimit administrativ se kjo adresë i përket apartamentit të prindërve të bashkëshortes, ku është transferuar vendbanimi në zyrën e gjendjes civile pas martesës në korrik të vitit 2010. Gjithashtu, subjekti pretendon se apartamenti objekt shqyrtimi ndodhet në të njëjtin pallat me apartamentin e prindërve të bashkëshortes, pa provuar se ku ka jetuar konkretisht nga viti 2010 deri në vitin 2013.

21.1.5. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, pretendoi se vëllai L. N. dhe bashkëshortja e tij i kanë sjellë dorazi kursimet e tyre dhe ia kanë dhënë për t’i mbajtur vëllait të tij K. N., i cili përkohësisht mund edhe t’i ketë përdorur një pjesë të tyre për biznesin e tij deri më datë 31.07.2009. Më pas janë depozituar nga nëna e tyre D. N. në “Fibank Albania”, dega Shkodër. Pas tërheqjes së kësaj shume nga subjekti i rivlerësimit, si person i autorizuar nga nëna e tij, kjo shumë është investuar në blerjen e shtëpisë në emrin e vëllait të tij L. N. në qytetin e Lezhës.

21.1.6. Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, vëllai L. N. ka ardhur rregullisht në Shqipëri për pushime të paktën një herë në vit ai vetë, por edhe më shpesh bashkëshortja e tij.

21.1.7. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ALUIZNI, Drejtoria Lezhë, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.03.2018, evidentohen dy formularë për legalizimin e shtesës: (i) “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës” të vitit 2006; (ii) kërkesë për legalizimin e ndërtimit pa leje/shtesës informale në objekt me leje nr. {***} prot., datë 16.07.2013. Në të dy dokumente për shtesat anësore të apartamentit me sipërfaqe 82,13 m², ndodhur në lagjen “{***}”, rruga “{***}”, Lezhë, aplikues për legalizim rezulton babai i subjektit të rivlerësimit, z. Z. N. N.. Formulari “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës” të vitit 2006, nënshkruar nga një nëpunës, i vulosur dhe i administruar nga institucioni shtetëror përkatës, konsiderohet shkresë me vlerë provuese në kuptim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile²⁷ dhe jo *letër pa vlerë apo shënim të ndonjë punonjësi*, sikundër pretendon subjekti i rivlerësimit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i administruar, formulari i vetëdeklarimit i vitit 2006, provon lidhur me vetëdeklarimin e z. Z. N., në vitin 2006, të shtesave në apartamentin e ndodhur në lagjen “{***}”, Lezhë. Sipas provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, materiale fotografike dhe hartografike, provohet se në vitin 2006 nuk ka filluar ndërtimi i shtesave në apartamentin

²⁵ Verifikuar në lëvizjet bankare të D. N., shkresa nr. {***} prot., datë 28.02.2019, “Fibank Albania” ShA.

²⁶ Referuar vërtetimit nr. {***} prot., datë 24.10.2019, nga “Fibank Albania” ShA, dorëzuar nga subjekti gjatë hetimit në Komision.

²⁷ Kodi i Procedurës Civile, në nenin 246 të titulluar “Fuqia provuese e shkresave” parashikon: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishje ose shtesa midis rreshtave ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”.

e ndodhur në lagjen “{***}”, Lezhë, por për sa do të analizohet hollësisht në vijim krijohet bindja se ky vetëdeklarim tregon për interesin e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, qysh në këtë vit, qoftë edhe në funksion të formalizimit të një marrëdhënie të mëvonshme.

21.1.8. Në kërkesën për legalizim të babait të subjektit të rivlerësimit, z. Z. N. dhe tre shtetasve të tjerë, që mban datën 16.07.2013, numër kontakti deklarohet, {***}, i cili përkon me numrin e telefonit të subjektit, i deklaruar prej tij në deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2013. Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit se në vitin 2003 babai i tij Z. N. ishte në pamundësi, për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore për ndjekjen e procedurave të lejes së ndërtimit dhe regjistrimin e pasurisë ndërtesë 3 kate, në {***}, Lezhë, bëjnë të pabesueshëm faktin që 10 vite më vonë, përkatësisht në vitin 2013, ka qenë e mundur ndjekja prej tij e procedurave të legalizimit, që për nga natyra nuk janë më pak komplekse. Për sa më sipër, trupi gjykues krijon bindjen se pavarësisht se praktika e legalizimit është në emër të babait të subjektit, z. Z. N., ndjekja e procedurave të legalizimit është bërë me angazhim të drejtpërdrejtë të subjektit të rivlerësimit.

21.1.9. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ALUIZNI-t nuk i është kërkuar kopje e plotë e të gjithë akteve të praktikës së legalizimit, ndërkohë që ky institucion nuk është shprehur se përcjell të plotë dokumentacionin, trupi gjykues vlerëson se është përgjegjësi dhe detyrim ligjor i institucioneve, që në zbatim të nenit 50, pika 6 e ligjit nr. 84/2016²⁸ në kuadër të procesit të rivlerësimit, t’i dërgojnë Komisionit informacionin dhe dokumentacionin e administruar prej tyre, sikundër rezulton të jetë përmbushur ky detyrim. Në këto kushte, trupi gjykues do të referojë praktikën e legalizimit të dërguar në Komision prej ALUIZNI-t. Deklarata noteriale, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.08.2015, e vëllait të subjektit L. N., nuk është pjesë e kësaj praktike të legalizimit të përcjellë në Komision nga ALUIZNI, Drejtoria Lezhë, por është përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2020, që kjo drejtori i ka kthyer përgjigje babait të subjektit të rivlerësimit, z. Z. N..

21.1.10. Në deklaratën noteriale të datës 05.08.2015, administruar në dosjet e Komisionit, pasqyrohet se [...] *Shtetasi L. Z. N. është pronar i [...] pasurisë apartament, sipërfaqe 82,13 m², adresa e pasurisë lagja “{***}”, Lezhë, bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 18.10.2010, lëshuar nga ZVRPP-ja Lezhë. Shtetasi L. Z. N. është dakord që të lejojë legalizimin dhe regjistrimin në ZVRPP-në Lezhë të një objekti shtesë 2 kate anësore dhe pjesërisht sipër apartamentit tim, e deklaruar nga babai im Z. N. N.. Kjo shtesë është bërë me pëlqimin dhe kontributin tim, prandaj shpreh pëlqimin për të vazhduar të gjitha procedurat pranë ALUIZNI-t Lezhë dhe ZVRPP-së Lezhë [...].* Subjekti pretendoi se kjo deklaratë është hartuar me qëllim kalimin e procesit të legalizimit nga babai, deklarues formal në vitin 2013, në emrin e vëllait L. N. ose së paku vijimin e lejimit të procesit në emër të babait, pasi në kohën e hartimit të deklaratës noteriale, sipas VKM-së nr. 474, datë 03.06.2015, nuk mund të bëhej ndryshimi i emrit të personit në emër të së cilit do të lëshohej leja e legalizimit. Ky fakt, sipas

²⁸ Ligji nr. 84/2016, në nenin 50 të titulluar “Aksesi në informacion” në pikën 6 të tij parashikon: “Brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo organ shtetëror dhe ent publik detyrohet të bashkëpunojë me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi, vonesat ose sjellja e papërshtatshme e procesit të verifikimit raportohen në zyrën e prokurorisë si vepër penale, sipas nenit 248, të Kodit Penal dhe përbëjnë shkelje disiplinore”.

subjektit, shpjegon se përse shtesat anësore janë regjistruar fillimisht në emër të babait të subjektit, z. Z. N., e më pas i janë dhuruar²⁹ vëllait të subjektit L. N., i përfaqësuar në këtë marrëdhënie dhurimi nga vëllai tjetër K. N..

21.1.11. Në kuadër të analizës më sipër, trupi gjykues çmoi të verifikojë mundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit L. N. dhe bashkëshortes së tij, për blerjen e apartamentit në vitin 2011 në vlerën 7.000.000 lekë dhe investimit e dy shtesave anësore, përfshirë mobilimin në vlerën 5.500.000 lekë. Sipas subjektit, shuma 7.000.000 lekë e ka origjinën nga depozita në “Fibank Albania” ShA, në emër të nënës së tij, e cila më datë 31.07.2009 ka depozituar shumën 60.000 euro, me burim *kursime familjare (nga puna në bujqësi dhe kontributi i fëmijëve jashtë vendit)*³⁰. Referuar lëvizjeve të kësaj llogarie bankare përcjellë nga “Fibank Albania” ShA³¹, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e personit të autorizuar [autorizim i brendshëm i bankës për të kryer transaksione bankare për llogari të nënës së tij] ka tërhequr më datë 03.08.2010 shumën 40.000 euro dhe më datë 03.03.2011 shumën 20.000 euro, shuma të cilat, sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, e kanë burimin nga *kursimet e punës së vëllait L. N., të sjella si remitanca në vendin tonë kohë pas kohe nga puna e tij dhe e bashkëshortes në Angli*. Me aktet e administruara nuk provohet që këto dy shuma të tërhequra nga subjekti i rivlerësimit të kenë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive. Subjekti i rivlerësimit i pyetur në seancë dëgjimore në Kolegj nuk dha shpjegime bindëse se përse këto depozita nëna e tij i kishte hapur në qytetin e Shkodrës, ndërkohë që vetë ishte me banim në qytetin e Lezhës.

21.1.12. Për sa më sipër, Kolegji nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, bazuar në aktet e administruara në dosje, kontrolloi analizën financiare të kryer në Komision lidhur me mundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit L. N. dhe bashkëshortes së tij, për periudhën 01.01.2004 deri më 31.07.2009, data e krijimit të depozitës. Në analizën financiare të kryer në Komision, verifikuar edhe në Kolegj, shpenzimet jetike të familjes së L. N. janë konsideruar në nivel varfërie, sipas statistikave zyrtare të EUROSTAT, rezultatet e analizës treguan se L. N. dhe F. N. nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e realizuara, investimet³² e kryera, si dhe kursimet në shumën 60.000 euro depozituar në llogarinë e D. N., në vlerën (-) 28.729 GBP apo konvertuar (-) 4.373.703 lekë. Përveç pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar nuk gjurmohet me asnjë dokument të kohës transferimi i fondeve nga L. N. në Shqipëri.

21.1.13. Lidhur me shtesat anësore me sipërfaqe përkatëse 68,26 m² dhe 78,06 m², shtesë të apartamentit me sipërfaqe 82,13 m², trupi gjykues konstaton se: (i) nuk rezulton që L. N. të këtë aplikuar për legalizimin e këtyre dy shtesave anësore të apartamentit në pronësi të tij, por aplikues rezulton babai Z. N.; (ii) nuk rezulton që L. N. t’i ketë poseduar asnjë moment këto pasuri, përkundrejt vlerës të konsiderueshme të krijimit të tyre; (iii) nuk rezulton që L. N. të

²⁹ *Nëpërmjet kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme “apartament” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.09.2016, me dhurues Z. N. dhe pranues dhurimi L. N..*

³⁰ *Referuar dokumentit “Deklaratë”, datë 31.07.2009, të nënshkruar dhe vulosur nga “First Investment Bank” ShA.*

³¹ *Me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2019.*

³² *Investimet: blerja e shtëpisë në vlerën 40.800 BGP në datën 25.04.2005, e paguar me kredi 5-vjeçare, me këste vjetore 8.160 GBP; (ii) blerë automjeti tip “Peugeot” në vlerë 2.300 GBP.*

ketë qenë prezent as në momentin e blerjes së apartamentit në vitin 2011 dhe as në vitin 2015, kur me anë të kontratës së dhurimit janë kaluar shtesat anësore në pronësi të tij dhe përfundimisht akti i huapërdorjes reciproke, pa shpërblim, mes tij dhe subjektit të rivlerësimit, i formalizuar mes tyre në periudhën e rivlerësimit, e bën të pabesueshëm krijimin e kësaj marrëdhënie, për më tepër edhe nga elementët e pasqyruar në të.

21.1.14. Për gjithë sa arsyetuar më sipër, në kushtet kur: (i) përdorimi i apartamentit së bashku me dy shtesat anësore prej vitit 2010 e në vazhdim nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore në kundërshtim me nenin 4, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar; (ii) hartimi i kontratës së huapërdorjes reciproke shtëpi banimi, daton më 11.10.2016, në periudhën e fillimit të procesit të rivlerësimit, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit e deklaroi në përgjigjet e pyetësorit standard se banon në këtë apartament që prej vitit 2013 e që ndodhet në të njëjtin kat me apartamentin në pronësi të prindërve të bashkëshortes; (iii) kryerja nga subjekti i rivlerësimit të transaksioneve bankare, tërheqja e shumave *cash* 40.000 dhe 20.000 euro nga llogaria bankare e nënës, e cila ka shërbyer për likuidimin e pagesës së apartamentit, sipas subjektit; (iv) pamjaftueshmëria financiare e vëllait L. N. për krijimin shumës së pretenduar; (v) duket jo bindës financimi prej vëllait L. N. në Shqipëri i një pasurie *apartment* në një vlerë konsiderueshëm më të lartë se shtëpia e banimit të tij në Angli ku jeton, ndërkohë që ky apartament do të përdorej prej familjes së tij vetëm për pushime, dy javë në vit, periudhë që, jo vetëm kishin plotësisht të mundur të akomodoheshin në banesën në {***}, referuar marrëdhënieve të posaçme, por edhe kontributeve të tij, të pretenduara prej subjektit, çojnë trupin gjykues në përfundimin se apartamenti me sipërfaqe 82,13 m² dhe dy shtesat me sipërfaqe respektive 68,26 m² dhe 78,06 m² janë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, e cila e kualifikon atë sipas nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Për analizën financiare 2005 – 2016

22. Komisioni për periudhën nën analizë ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitet 2012, 2013 dhe 2014, në vlerën totale (-) 465.751 lekë.
23. Subjekti i rivlerësimit ankimon përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për vitet 2012, 2013 dhe 2014 me pretendimin se është zbatuar gabim informacioni i ILDKPKI-së në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, logjikën ekonomike dhe mënyrën e tij reale të jetesës.
24. Trupi gjykues, me konsideratë qëndrimin e konsoliduar në jurisprudencën e tij, në linjë me Komisionin, në analizën financiare, konsideroi të dhënat zyrtare të INSTAT, përcjellë Kolegjit nga ILDKPKI-ja, referencë për të gjithë subjektet e rivlerësimit.
25. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, lidhur me të ardhurat nga shitja e njësisë me sipërfaqe 12 m², të cilat kanë shërbyer më pas si burim krijimi të shumës 5.200.000 lekë, për pasurinë apartament me sipërfaqe 129,4 m² e porositur me anë të kontratës së porosisë, në vitin 2014, në {***}, Tiranë, trupi gjykues konstaton që Komisioni nuk ka qenë konsistent, pasi në paragrafin e katërt të faqes 35, shprehet se [...] *burimi financiar i përdorur nga subjekti për*

*blerjen e këtij apartamenti, që është në pjesën më të madhe të tij nga shitja e njësisë në Lezhë më 03.08.2009, për çmimin 3.200.000 lekë, duket që nuk është burim i besueshëm [...], ndërsa në paragrafin e pestë të faqes 69 të vendimit, citon se të gjitha këto argumente çojnë në konkluzionin se çmimi i shitjes prej 3.200.000 lekësh, pavarësisht se është marrë në konsideratë nga Komisioni, është një çmim jo i besueshëm, i paracaktuar nga palët kontraktuese, të cilat kishin njohje të mëparshme, me qëllim ligjërimit në emër të subjektit dhe përdorimin në mënyrë të ligjshme në një kohë të mëpasshme të të ardhurave të krijuara me burime të paidentifikuara nga subjekti i rivlerësimit sikurse edhe ka ndodhur me përdorimin e shumës 3.200.000 lekë për blerjen e apartamentit të shoqëria “{***}” ShPK.*

Pra, Komisioni, edhe pse ka arsyetuar se shuma e përfituar nga shitja e njësisë 12 m² nuk është e besueshme, përsëri e ka përfshirë në analizën financiare si të ardhur të ligjshme [tabela nr. 9, analiza financiare e rishikuar për periudhën 2003-2016, faqe 83 e vendimit], duke konkluduar me pamjaftueshmëri të pakonsiderueshme për krijimin e shumës prej 5.200.000 lekësh, për porositjen e apartamentit në {***}. Nëse diferencës negative të konstatuar do t'i shtohet mungesa në vlerën 3.200.000 lekë, atëherë pamjaftueshmëria do thellohej ndjeshëm.

26. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, duke mospërfshirë të ardhurën nga shitja e njësisë në vlerën 3.200.000 lekë, sikurse arsyetuar në paragrafin 16.6 të këtij vendimi, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për vitet 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014, në vlerën (-) 3.074.239 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Megjithatë në kushtet kur problematikat e konstatuara dhe vlerësimet e arritura për pasuritë: (i) apartament banimi ndodhur në {***}, Tiranë; (ii) njësi ndodhur në qytetin e Lezhës; si dhe (iii) apartament me dy shtesat anësore në qytetin e Lezhës, janë të mjaftueshme për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji, në kushtet e vënies në lëvizje nga ankimi i subjektit të rivlerësimit, në zbatim të parimit *non reformatio in peius*, vendosi të mos ndryshojë vlerën negative të konstatuar nga Komisioni (-) 465.751 lekë.
27. Në kushtet kur mangësitë e konstatuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe kur nuk ekzistojnë rrethana të tjera lidhur me këtë kriter, problematikat e këtij kriteri nuk mund t'i ngarkohen rishtazi subjektit edhe në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
28. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Aleks Nikolli ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë nën dritën e parashikimeve të nenit D, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 290, datë 10.08.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Aleks Nikolli, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 290, datë 10.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Aleks Nikolli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 14.07.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi